# GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXVI - Nr. 7797 E hënë 18 Shkurt 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)










Dje në "Zëri i Amerikës"

Nga ILIR IKONOMI



## Nju Jork: Shqiptarët mbledhin fonde për çështjen e vëllezërve Bytyçi

Në Nju Jork, festimi i përvjetorit të pavarësisë së Kosovës u shënua mbrëmë në një mënyrë të veçantë. Rreth 30 shoqata shqiptaro-amerikane organizuan një mbledhje... Vijon në faqen 21

Opinioni i Ditës

Nga NADIE AHMETI



## Kosova shënon 11-vjetorin e Pavarësisë

Në 11-vjetorin e Pavarësisë, Kosova po zhvillohet gradualisht me gjithë sfidat që i paraqiten përpara, kanë vlerësuar udhëheqës të institucioneve të Kosovës... Vijon në faqen 20




Deputeti socialist flet për "Gazetën Shqiptare"

## Spartak Braho e konfirmon: Djali im i vetofrohet PS për Bashkinë Durrës

"Mazhoranca do vazhdojë të qeverisë deri 2026 me këtë opozitë që çdo 6 muaj 'vret veten'"

Deputeti socialistë, Spartak Braho në një intervistë për "Gazetën Shqiptare", teksa komenton protestën e opozitës, shprehet se ngjarjet që shoqëruan 5 orët e tubimit para Kryeministrisë ishin fundi i një "komedie me aktorë politikë që bllofuan se do luanin tragjeditë e Eskilit". Gjithashtu, ai shprehet se me... Në faqen 5

THELLOHET NE VEND KRIZA POLITIKE PAS PROTESTES. PS: KY ESHTE VETASGJESIM

# PROPOZIMI I BASHES: PER SHQIPTARET DJEGIM MANDATET

Rama: Opozita goditi Shqipërinë në sytë e botës, u dha material skeptikëve. Të arrestuarit, në kërkim edhe shtatë protestues të tjerë për trazirat





*(Në foto)* Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, protesta e fundit e opozitës Në faqet 2-3

DETAJE TE PATHENA

### Prokurori italian: Mafia shqiptare në rritje, e ashpër e aleate me 'Ndranghetan'

Në faqen 6

LISTA E PLOTE

### Zbardhen emrat e 400 fituesve që aplikuan në portalin e infermierëve

Në faqet 10-12

PERSONAZH

### Shqiptari Fatos Malaj hedh kandidaturën për deputet në parlamentin grek

Në faqen 18

NGJARJA HISTORIKE

### Kosova në festë, 11 vite shtet, Pompeo e shqiptarët urojnë kosovarët

Në faqen 9

MJEKU POPULLOR: KUSH JUA SHPIF DUHANIN




### Gerald Kola: Kujdes nga gurët në tëmth, mund të mos shfaqin simptoma papritmas

Suplement

Shpëton 'shënjestra" Armando Sulejmani, vdesin Aurest Rexho dhe Arjan Hasani

## Krim i dyfishtë në Vlorë, vriten miqtë e "Çipurit"

*E shkuara e të dyshuarit që ka qenë pjesë e bandës së Gaxhait*

Nga ENRIK MEHMETI



VLORË-Krim i rëndë në Vlorë. Dy persona janë ekzekutuar me armë zjarri, ndërsa një tjetër ka mbetur i plagosur. Ngjarja në zonën e "Ujit të Ftohtë në Vlorë" në rrugën e kthimit nga bregdeti. Mësohet se të vrarë kanë mbetur shtetasit Aurest Rexho dhe Arjan Hasani. Ndërsa i plagosur ka mbetur shtetasi Armando Sulejmani, 42 vjeç, i cili dyshohet se ka qenë dhe shënjestra e atentatit për shkak të të kaluarës së tij dhe precedentëve. Sulejmani ndodhej në pjesën... Në faqet 6-7

# POST - PROTESTA

## MANDATET

Kryeministri akuzoi opozitën se me dhunën e ushtruar prishi imazhin e vendit

# Rama: Opozita goditi Shqipërinë në sytë e botës, u dha material skeptikëve

"Çfarë trishtimi pasqyra e shëmtisë së djeshme (pardjeshme)"

Kryeministri Edi Rama ka akuzuar opozitën e djathtë se me protestën e saj dhe me aktet e dhunës ndaj institucionit të Kryeministrisë dëmtoi mbi të gjitha imazhin e Shqipërisë në sytë e ndërkombëtarëve. Dhe për këtë ai i është referuar pikërisht pasqyrimit që media të njohura ndërkombëtare i bënë protestës së opozitës, në datë 16 shkurt në bulevardin "Dëshmorët e Kombit". Nëpërmjet një statusi në rrjetet sociale, kryeministri Rama thekson se protesta nuk i bëri dot asgjë qeverisë, por veçse goditi imazhin e vendit tonë në sytë e të huajve. Madje ai thekson se imazhet që përcollën mediat e huaja akteve të dhunës ndaj godinës së kryeministrisë mund të përbëjnë një shkas edhe për ato vende që skeptike ndaj hapjeve të negociatave dhe vijimit më tej të procesit të integrimit të Shqipërisë. "Çfarë trishtimi pasqyra e shëmtisë së djeshme nëpër mediat e dynjasë! Politika qorre e një opozite pa vizion, pa program, pa lidership, nuk i bëri asgjë dot qeverisë po goditi Shqipërinë në sytë e botës dhe u dha material të tërë atyre që duan sebepe kundër negociatave me BE #TURP", - shkroi Rama dje në "Twitter". Ndërkohë që media tradicionale dhe online i bënë një jehonë të gjerë protestës së ditës së shtunë në Tiranë, duke evidentuar dhunën ndaj institucionit të qeverisë. 'Euronews' i bëri një pasqyrim në kohë reale ngjarjeve duke evidentuar sulmin ndaj selisë së Këshillit të Ministrave. "Protestuesit nisën të shkallmojnë dyert e zyrës së Kryeministrit të Shqipërisë në Tiranë. Kjo po ndodh gjatë protestës së opozitës kundër korrupsionit qeveritar", - shkroi "Euronews" që e transmetoi të gjithë tubimin online. Ndërkohë që media amerikane "Washington Post" në versionin online i kushtoi një artikull të gjatë ngjarjeve në Tiranë, ndërsa thekson faktin se mijëra qytetarë protestuan kundër qeverisë të cilën e konsiderojnë të korruptuar. "Washington Post" shkroi se mijëra mbështetës të opozitës në Shqipëri u përplasën me policinë në një protestë antiqeveritare, ndërsa çanë kordonin e policisë duke tentuar të futen edhe në kryeministri. Ndërsa "Reuters" shkroi se "protestuesit, pasi hodhën bomba molotov u përpoqën të thyejnë xhamat e Kryeministrisë, duke i goditur me mjete të forta". Media tjetër italiane "La Repubblica", gjithashtu, e vuri theksin tek dhuna e treguar në protestë dhe përpjekjet për t'u futur në Kryeministri. "Dhunë në protestën e opozitës në Tiranë. Mijëra persona kanë dalë në sheshin e kryeqytetit shqiptarë duke protestuar kundër qeverisë së Edi Ramës, duke kërkuar dorëheqjen e Kryeministrit. Protestuesit, të organizuar nga Partia Demokratike, thyen kordonin e policisë duke kërkuar të futen në Kryeministri me dhunë", - shkroi 'La Republica'. Ndërsa "Vorriere della Sera", publikoi një shkrim të Alessio Vinccit, ish-korespondentit të CNN, ku e konsideronte protestën jo fryt i revoltës qytetare, por produkt i përplasjeve politike. Ndërkohë që media kryesore greke "Ta Nea", duke iu referuar fjalimeve të kryedemokratit Basha thekson se policia i la vetë protestuesit që t'i afroheshin godinës për të ushtruar dhunë.



Protestues të opozitës duke sulmuar Kryeministrinë

**PASQYRIMI**

"Çfarë trishtimi pasqyra e shëmtisë së djeshme nëpër mediat e dynjasë! Politika qorre e një opozite pa vizion, pa program, pa lidership, nuk i bëri asgjë dot qeverisë po goditi Shqipërinë në sytë e botës dhe u dha material të tërë atyre që duan sebepe kundër negociatave me BE #TURP", - shkroi Rama



Protesta e fundit e opozitës para Kryeministrisë

## Vendimi i PD për mandatet, PS: Basha ka vendosur të djegë opozitën



Pasi Basha deklaroi dje se do t'i propozojë grupit parlamentar dhe forumeve më ta larta djegien e mandateve të deputetit, edhe menjëherë një reagim nga radhët e socialistëve. Ministrja e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin dhe zëdhënësja e qeverisë, Elisa Spiropali nëpërmjet një postimi në rrjetet sociale u shpreh se ky vendim i PD-së krahas të keqes e ka edhe një të mirë. Ajo thekson se e mira është se nuk do t'i marrin më rrogat për të ndotur me bojë e baltë parlamentin. "Lulzim Basha tha se do digjte qeverinë dhe paska vendosur të djegë opozitën! Singerisht nuk do ta dëshironim kurrsesi degradimin e tyre konstant, po në këto kushte, duhet pohuar kjo e keqe e ka një të mirë: Nuk do t'i marrin më rrogat për ta ndotur Parlamentin me baltë e bojë!", - shkroi Spiropali. Ndërkohë që dy ditë më parë, kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla duke folur në News 24 për skenarin e djegies së mandateve deklaroi se kjo nuk kishte për të ndodhur pasi kryetarët e dy forcave kryesore politike të opozitës nuk i lëshonin mandatet e tyre. "Mos kini merak se Luli dhe Monika nuk i lëshojnë mandatet. Monika e ka shumë merak dhe pjesën e rrogës dhe nuk i lëshojnë mandatet. Le të mbyllet këtu ky diskutim. Nuk i lëshojnë mandatet. Ata bëjnë çdo gjë. U betuan që nuk do të vinin më në Kuvend dhe sa u plotësua 6 mujori erdhën aty si pulat pa dhënë asnjë arsye pse munguan", - tha Balla.



## Lënia e mandatit, ja çfarë parashikon Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor

Heqja dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë nuk është një precedent i panjohur për politikën shqiptare. Ndonëse nuk ka pasur lënie kolektive të mandatit para KQZ-së, në mënyrë individuale kjo ka ndodhur shumë herë në gjithë këto vite tranzicion. Rastet më të fundit janë ato të deputetëve, Eduard Halimi nga Partia Demokratike dhe Sajmir Tahiri nga Partia Socialiste. Në të dyja rastet ata paraqitën një kërkesë në Kuvend ku shprehnin vullnetin për të lënë mandatin dhe ky i fundi këtë vullnet ia përcolli më pas KQZ-së, i cila bëri dhe zëvendësimin e tyre me kandidatë nga lista pasuese. Por çfarë parashikon legjislacioni ynë lidhur me këtë rast? Neni 71, pika 2, germa "b" e Kushtetutës parashikon se "Mandati i deputetit mbaron ose është i pavlefshëm, sipas rastit, ndërmjet të cilave edhe "kur heq dorë nga mandati". Detaje të mëtejshme në lidhje me këtë situatë janë parashikuar nga neni 164 i Kodit Zgjedhor, i cili përcakton se "Në rastin e shkronjave "a" dhe "b" të pikës 2 të nenit 71 të Kushtetutës, deputeti deklaron në mënyrë publike përpara komisionit përkatës të Kuvendit refuzimin për të bërë betimin ose heqjen dorë nga mandati. Në këtë rast Kuvendi, jo më vonë se 30 ditë, njofton KQZ-në për krijimin e vakancës". Por gjithsesi ky nen i Kodit Zgjedhor është pak i paqartë pasi ndërmjet të tjerave përcakton se "Nuk përbëjnë shkak për ndërprerje të mandatit marrëveshjet apo deklaratat paraprake individuale apo kolektive për heqje dorë nga mandati". Gjithsesi nisur nga rastet e mëparshme të përmendura më lartë kjo paqartësi është zgjidhur dhe çdo deputet në mënyrë individuale mund të heq dorë nga mandati. Por krahas kësaj Kushtetuta dhe Kodi përcakton edhe një rrugë tjetër, atë të mungesës për 6 muaj në Kuvend. Por kjo do ishte një rrugë më e gjatë dhe do t'i jepte efektet më vonë, ndërkohë që opozitës i duhet një rrugë që të krijojë premisat për një zgjidhje sa më të shpejtë.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu*:** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



# Djegia e mandateve? Kryemadhi: Rama nuk ka parë asgjë akoma

Lëvizja Socialiste për Integrim nuk është shprehur ende në lidhje me propozimin që kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha i bëri grupit të tij parlamentar për të djegur mandatet e deputetëve. Ndonëse kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi bëri dje një koment lidhur me zhvillimet politike në vend, nuk e preku në të temën e djegies së mandateve, ndërsa u morr vetëm me kryeministrin Edi Rama. Nëpërmjet këtij statusi, Kryemadhi u shpreh se kryeministri nuk ka parë asgjë akoma dhe se beteja e opozitës do të vijojë më tej. "Beteja kundër Ramës dhe bandave të krimit vazhdon. Nuk ka parë gjë akoma!", - shkroi ajo, por pa dhënë një përgjigje për interesin që shprehën mediat e ndryshme dje ndaj këtij propozimi të fundit të kryedemokratit. Ndërkohë që më parë Kryemadhi kur është pyetur rreth këtij propozimi ka qenë disi e lëkundur nëse duhet ta mbështeste një veprim të tillë ekstrem apo jo. Sipas saj mandatet e opozitës janë në mandate të marra me gjak dhe se ato që duhet të digjeshin ishin mandatet e përfaqësuesve të mazhorancës, që sipas saj janë mandate që kanë dalë nga votat e blera dhe presioni i krimit. "Nuk është çështje e djegies së mandatave, mandatet tona janë mandate gjaku, këtu është momenti të djegin mandatet trafikantët", - tha Kryemadhi në një deklaratat e saja mediatike gjatë dhjetorit të shkuar.




Mandatet e opozitës janë në mandate të marra me gjak dhe se ato që duhet të digjeshin ishin mandatet e përfaqësuesve të mazhorancës, që sipas saj janë mandate që kanë dalë nga votat e blera dhe presioni i krimit

Thellohet kriza politike, pas protestës demokratët drejt djegies së mandateve

# Basha: I propozoj grupit të PD të djegim mandatet e deputetëve

## *"Thika ka shkuar në palcë dhe koha e fjalëve ka mbaruar"*

Thellohet kriza politike në vend. Pas protestës së mbajtur të shtunën, Partia Demokratike si forca me e madhe opozitare ka ndërmarrë një tjetër hap edhe më ekstrem, djegien e mandateve të deputetëve të saj. Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha i ka propozuar zyrtarisht grupit të tij parlamentar djegien e mandateve si një veprim që vjen si pasojë e ezaurimit të të gjitha rrugëve për t'i kthyer parlamentit legjitimitetin e vet, por edhe si plotësim i një kërkese të vazhdueshme të qytetarëve. "Unë jam sot këtu për t'ju thënë me përgjegjësi të plotë se e kam lexuar vullnetin tuaj. Ndaj, kam vendosur t'i propozoj grupit parlamentar dhe forumeve më të larta vendimmarrëse të PD djegien e mandateve parlamentare, në mbështetje të qëllimit dhe aspiratës që ju dje dëshmuat se është mbarëkombëtare, europiane dhe e pandalshme: Mbrojtjen e demokracisë dhe shtetit të së drejtës; Shqipërinë si gjithë Europa; Qeveri tranzitore dhe zgjedhje të lira dhe të ndershme; parlament të popullit dhe jo të krimit", - deklaroi kryetari i PD-së, Lulzim Basha në një dalje të posaçme për mediat nga selia e PD-së. Ai theksoi se ky vendim drastik vjen si një përgjigje ndaj mesazhit që dhanë qytetarët me protestën e tyre, por edhe shurdhërisë së mazhorancës për të pranuar kërkesat e opozitës për të kthyer legjitimitetin e institucioneve në vend. "Duke ju falënderuar për besimin e demonstruar dje, ju siguroj se e unë e kam dëgjuar dhe kuptuar shumë qartë mesazhin tuaj me pjesëmarrjen dhe bashkimin në protestën më të madhe që ka patur ndonjëherë vendi. Mesazhi juaj është i qartë: Kështu nuk vazhdohet më! Kupa është mbushur dhe është derdhur. Thika ka shkuar në palcë dhe koha e fjalëve ka mbaruar. Ne nuk do të vazhdojnë të jemi më fasadë e një parlamenti të dalë nga zgjedhje që i ka diktuar krimi i organizuar. Mbështetja juaj, e dëshmuar dje, mori përmasat e një referendumi për zgjidhjen politike, të ofruar nga opozita", - shtoi më tej Basha. Gjithashtu, ai theksoi se PD ka ezauruar të gjitha rrugët e tjera politike për të siguruar një parlament që vjen si fryt i vullnetit të votës së lirë të qytetarëve dhe se tashmë nuk i ka mbetur rrugë tjetër veçse luftën e saj ta bëj bashkë me qytetarët shqiptarë çdo ditë, në çdo rrugë dhe shesh. "Ne kemi ndjekur të gjitha rrugët institucionale për të mbrojtur demokracinë, për të mbrojtur interesin e qytetarëve. Por, përballë, nuk kemi një parti politike. Nuk kemi një kryeministër dhe qeveri politike të zgjedhur nga qytetarët. Përballë kemi një bandë, që ka ardhur në pushtet nga bashkëpunimi me bandat dhe qeveris për llogari të bandave", - deklaroi Basha. Ndërkohë që duke u ndalur te protesta e së shtunës, ai theksoi se ajo ishte më e madhja e zhvilluar ndonjëherë në vend dhe se ajo tregoi se edhe shqiptarët ashtu si çdo vend tjetër në një shtet demokratik treguan se nuk mund ta pranojnë një qeveri që nuk i përfaqëson. "Gjermanët, francezët, britanikët, italianët, amerikanët nuk pranojnë kurrë t'i qeverisë dikush që është kapur duke blerë votat e tyre, bashkë me krimin. Për fat të mirë, prej 16 Shkurtit, këtë nuk e pranojnë më as shqiptarët! Protesta më e madhe, që pas pluralizmit dhe, pra, më e madhja ndonjëherë, i tregoi mbarë botës dje se ne, shqiptarët, jemi popull europian, jo thjesht në gjeografi, por në vlera dhe besim tek demokracia dhe shteti i së drejtës", - u shpreh më tej kryetari i PD-së. Edhe një herë ai përsëriti kërkesën për një qeveri tranzitore që do mundësojë zgjedhjen së pari të një parlamenti të dalë nga vota.



Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha

**THIRRJA**

"Kështu nuk vazhdohet më! Kupa është mbushur dhe është derdhur. Thika ka shkuar në palcë dhe koha e fjalëve ka mbaruar. Ne nuk do të vazhdojnë të jemi më fasadë e një parlamenti të dalë nga zgjedhje që i ka diktuar krimi i organizuar. Mbështetja juaj, e dëshmuar dje, mori përmasat e një referendumi për zgjidhjen politike, të ofruar nga opozita"

## PDIU: Po, propozimit të Bashës. Ndoka: Nuk ka qëndrim të opozitës

Propozimi i kryetari të Partisë Demokratike, Lulzim Basha për djegien e mandateve të deputetëve ka gjetur mbështetjen e një pjese të aleatëve të tij. E para që u shpreh publikisht pro këtij propozimi ishte Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet, e Shpëtim Idrizit. Nëpërmjet një deklarate të shpërndarë për mediat PDIU ka mbështetur propozimin e Bashës ndërsa ka kërkuar zgjedhje të parakohshme dhe krijimin e një qeverie tranzitore. "PDIU mbështet vendimin e PD-së për ti dhënë zgjidhje politike vendit, si i vetmi instrument që politika e përgjegjshme ka për të zgjidhur krizën shumëdimensionale që sot ka kapluar vendin, krizë politike, ekonomike, sociale dhe krizë përfaqësimi, nëpërmjet zgjedhjeve të parakohshme dhe një qeverie tranzitore, që do të garantojë që shqiptarët të votojnë dhe të zgjedhin për herë të parë të lirë. Vlerësojmë propozimin e z. Basha për djegien e mandateve, si një shprehje e vullnetit të qartë, që para zërit të qytetarëve dhe nevojës së vendit për zgjidhje politike, nuk vuri status quo-në e një parlamenti ilegjitim, por bëri fakt zgjidhjen politike që kjo mazhorancë po e refuzon me arrogancë", - thuhet në këtë deklaratë. Po ashtu edhe PDK e Nard Ndokës ka mbështetur në parim një propozim të tillë, ndonëse deklaron se nuk ka një vendim të opozitës për këtë çështje. "Nuk ka një qëndrim si opozitë e bashkuar. Unë në parim jam dakord", - tha Ndoka i pyetur nga 'Gazeta Shqiptare'.



PROTESTA

DHUNA

Forcat blu kanë shpallur në kërkim edhe 7 protestues të tjerë për trazirat në protestë

# Aktet e dhunës, policia arreston Florenc Hoxhën dhe 14 persona të tjerë

## *Të arrestuarit akuzohen për 4 vepra penale*

Pasi shoqëroi një numë të konsiderueshëm personash që morën pjesë në protestën e së shtunës, Policia e Shtetit ka arrestuar 15 prej tyre, ndërkohë që 5 persona të tjerë i ka proceduar në gjendje të lirë dhe 7 të tjerë i ka shpallur në kërkim. Ky është bilanci i masave që ka marrë policia për shkaktarët e trazirave që shoqëruan protestën e opozitës ditën e shtunë dhe ku nuk munguan aktet e dhunës kundër godinës së Kryeministrisë. Nëpërmjet një deklarate të shpërndarë në media zyrtarisht deklarohet se pas analizimit të pamjeve filmike, raportit të shërbimeve dhe provave të tjera të mbledhura, gjatë protestës së djeshme ku pati akte të dukshme dhune, policia ka arrestuar 15 shtetas për veprat penale "Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik", "Goditje për shkak të detyrës", "Shkatërrimi i pronës" dhe "Prishja e qetësisë publike".

Gjithashtu, u proceduan penalisht në gjendje të lirë 5 shtetas, si dhe janë shpallur në kërkim dhe po punohet për kapjen e 7 të tjerëve. Mes të arrestuarve është edhe ish-kreu i Policisë Bashkiake Florenc Hoxha. Gjithsej janë 7 të arrestuar nga Tirana, 1 nga Kavaja, 2 nga Shkodra, 1 nga Divjaka, 1 nga Durrësi, 1 nga Elbasani, 1 nga Cërriku dhe 1 nga Fieri. "Shërbimet e Policisë Tiranë arrestuan në flagrancë 15 shtetas: Florenc Hoxha, 44 vjeç, banues në Tiranë; E.N., 28 vjeç, banues në Tiranë; Naim Haxhiaj, 51 vjeç, banues në Kavajë; A.Gj., 54 vjeç, banues në Divjakë; R.D., 23 vjeç, banues në Tiranë; S.D., 41 vjeçe, banuese në Tiranë; D.L., 33 vjeç, banues në Shkodër; H.J., 76 vjeç, banues në Tiranë; Ilir Hamedinaj, 49 vjeç, banues në Durrës; F.T., 44 vjeç, banues në Tiranë; S.R., 43 vjeç, banues në Cërrik; M.F., 55 vjeç, banues në Elbasan; L.J., 38 vjeç, banues në Tiranë; P. Sh., 51 vjeç, banues në Shkodër; Velion Dine, 30 vjeç, banues në Fier", - thuhet në njoftimin e Policisë së Shtetit. Policia deklaron se këta shtetas gjatë zhvillimit të tubimit në datë 16.02.2019, pas orës 11:00, në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit", kanë çarë kordonin e policisë duke kundërshtuar e goditur punonjësit e policisë, të cilët ishin të planizuar me shërbim për garantimin paqësor të tubimit. Gjithashtu, kanë goditur dhe thyer me mjete të forta, dyert, xhamat dhe vepra arti në hyrjen kryesore të Kryeministrisë së Republikës së Shqipërisë. Policia bën të ditur se janë proceduar në gjendje të lirë 5 shtetas dhe konkretisht: G.D., 25 vjeç, banues në Tiranë; A.T., 20 vjeç, banues në Tiranë; R.B., 53 vjeç, banues në Përrenjas; D.Ll., 47 vjeç, banues në Tiranë; P.Th., 52 vjeç, banues në Shkodër. Gjithashtu, janë shpallur në kërkim dhe po punohet për kapjen e 7 shtetasve të tjerë. Policia e Shtetit bën me dije se materialet iu dërguan për veprime të mëtejshme Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndërkohë që Partia Demokratike ka akuzuar Policinë e Shtetit se ka bërë shoqërime dhe arrestime të paligjshme, si dhe nga ushtruar dhunë ndaj protestuesve. Dy net më parë një pjesë e deputetëve demokratë u përplasën edhe fizikisht me punonjësit e Policisë në Drejtorinë e Policisë Tiranë, teksa kërkuan lirimin e të atë shoqëruarve.



**AKUZAT**

Pas analizimit të pamjeve filmike, raportit të shërbimeve dhe provave të tjera të mbledhura, gjatë protestës së djeshme, ku pati akte të dukshme dhune, policia ka arrestuar 15 shtetas për veprat penale "Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik", "Goditje për shkak të detyrës", "Shkatërrimi i pronës" dhe "Prishja e qetësisë publike".

**TË ARRESTUARIT**

- F.H., 44 vjeç, banues në Tiranë;
- E.N., 28 vjeç, banues në Tiranë;
- N.H., 51 vjeç, banues në Kavajë;
- A.Gj., 54 vjeç, banues në Divjakë;
- R.D., 23 vjeç, banues në Tiranë;
- S.D., 41 vjeçe, banuese në Tiranë;
- D.L., 33 vjeç, banues në Shkodër;
- H.J., 76 vjeç, banues në Tiranë;
- I.H., 49 vjeç, banues në Durrës;
- F.T., 44 vjeç, banues në Tiranë;
- S.R., 43 vjeç, banues në Cërrik;
- M.F., 55 vjeç, banues në Elbasan;
- L.J., 38 vjeç, banues në Tiranë;
- P. Sh., 51 vjeç, banues në Shkodër;
- V. D., 30 vjeç, banues në Fier.

**U PROCEDUAN TË LIRË:**

- G.D., 25 vjeç, banues në Tiranë;
- A.T., 20 vjeç, banues në Tiranë;
- R.B., 53 vjeç, banues në Përrenjas;
- D.Ll., 47 vjeç, banues në Tiranë;
- P.Th., 52 vjeç, banues në Shkodër.


NJOFTIM ANKANDI

1. **Shoqëria e Përmbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k** njofton Shpalljen e Ankandit të III (tretë), për shitjen e pasurisë ULLISHTE , me sip.3,400 m², Zona Kadastrale: 1615 Numri i Pasurisë: 327/1, Vol. 1, Faqe 221, ndodhur në Fier-Shegan Lushnje, në pronësi të: z.Bajram Sefer Skraqi , I datëlindjes 14.11.1967. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në vlerën **1,713,600 (një milion e shtatëqind e trembëdhjetë mijë e gjashtëqind) Lekë.**

Ankandi do të zhvillohet më datë **12.03.2019**, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përmbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k , në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.telefon 042320227, email: elvinth@hotmail.com. Publikimi i njoftimit te ankandit te fillojë me date 08.03.2019 deri me date 12.03.2019.




Protesta e fundit e opozitës

## SHKURTE

### Shehaj për median italiane: Protesta ishte popullore, Rama si Maduro

Deputeti i PD Agron Shehaj foli për mediat italiane pas protestës popullore të thirrur dje nga opozita shqiptare. Në një prononcim për "Radio popolare" në Milano, Shehaj tha se protesta u mbështet nga qytetarët në masivitet aq sa detyroi kreun e qeverisë të bëjë antimiting në Vlorë, njësoj si diktatori i Venezuelës Maduro. Shehaj tha me tej se protestat do të vazhdojë deri në rrëzimin e sistemit të korruptuar që mbizotëron sot në Shqipëri. "Ishte një protestë e thirrur nga qendra e djathtë në Shqipëri që u kthye ne protestë popullore kur korrupsionit gjigand që ka në vend. Një rast i fundit u faktua se si 30 milionë euro u vodhën me një skemë kompanie fantazmë ofshore e krijuar pak muaj më parë në shtetin amerikan të Delaware. Se dy është faktuar se ne zgjedhjet e fundit janë përdorur banka kriminale nga pushteti për të bërë vota. Protesta ngjan me situatën në Venezuelë, sepse kreu i qeverisë organizoi një antimiting në jug ne vendit, në Vlorë për t'iu përgjigjur protestës popullore në kryeqytet. Protestat do të vazhdojnë. E ardhshmja do të jetë ditën e enjte",-tha Shehaj.

### Vasili: Qeveria hodhi gaz helmues, pse heshtin ambasadorët?

Kryetari i grupit parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim, Petrit Vasili ka akuzuar dje qeverinë se nëpërmjet Policisë së Shtetit hodhi gaz helmues ndaj protestuesve të opozitës. Sipas tij përdorimi masiv i gazit në protesta është i ndaluar, pasi shkakton probleme serioze me shëndetin e njeriut. Dje qeveria provokoi me gaz helmues luftarak qytetarët protestues. Gazi helmues luftarak përdoret kundër armiqve dhe jo masivisht kundër qytetarëve siç bëri qeveria dje. Pasojat kohëgjata mbi shëndetin e njerëzve deri edhe në vdekje janë provuar shkencërisht", - tha Vasili. Më tej ai i drejtoi pyetje edhe përfaqësive diplomatike në vendin tonë që pse heshtin para këtij fakti, ku qeveria, sipas tij, i përdor qytetarët si armiq. "Pse heshtin ambasadorët përpara një provokimi kriminal të qeverisë, që trajton qytetarët si armiq??? Çfarë i pengon ata që të distancohen prerë nga një sjellje kriminale e një qeverie në minorancë? Pse mbyllin sytë ambasadorët përpara mijëra qytetarëve, gazetarëve, policëve, të moshuarve e të rinjve, që nxjerrin shkumë nga goja nga gazi helmues i qeverisë?", - shkroi Vasili.

Deputeti socialist shprehet se me vendimin për djegien e mandateve PD vetasgjësohet

# Spartak Braho e konfirmon: Djali im i vetofrohet PS për Bashkinë e Durrësit

## "Mazhoranca do vazhdojë të qeverisë deri 2026"



*Deputeti socialistë, Spartak Braho në një intervistë për "Gazetën Shqiptare", teksa komenton protestën e opozitës, shprehet se ngjarjet që shoqëruan 5 orët e tubimit para Kryeministrisë ishin fundi i një "komedie me aktorë politikë që bllofuan se do luanin tragjeditë e Eskilit". Gjithashtu, ai shprehet se me vendimin për të djegur mandatet PD po bën vetëvrasje politike. Pavarësisht kësaj mase ekstreme, ai thekson se kjo nuk do ta pengojë Partinë Socialiste që të qeverisë deri në fund të mandatit që i kanë dhënë shqiptarët. "Do të jetë një vetëvrasje tjetër në kushtet e dëshpërimit. Në dëshpërim njeriu vetekzekutohet. Po jeta parlamentare vazhdon edhe më pas pasi mazhoranca i ka 80 deputetë", - shprehet Braho. Jo vetëm kaq, por duke e konsideruar si diletantizëm sjelljen e PD dhe LSI, ai thekson se me këtë lloj opozite Partia Socialiste do fitojë edhe zgjedhjet e 2022. "Maxhoranca do vazhdojë të qeverisë deri 2026 me këtë opozitë që çdo 6 muaj "vret veten" por pa mendjemadhësi", thekson Braho në këtë intervistë, ndërsa hedh poshtë çdo lloj mundësie për ripërsëritjen e një marrëveshje të ngjashme me atë të majit të 2017 mes PD dhe PS. Duke folur për zgjedhjet vendore në qarkun e Durrësit ku ai bën dhe jetën politike partiake, Braho nuk e fsheh dëshirën e djalit të tij për të kandiduar për kryetar të Bashkisë së Durrësit. Sipas tij kjo dëshirë vjen për shkak të kontributit që djali i tij, Arbër Braho ka dhënë si nënkryetar i kësaj bashkie prej 5 vitesh. "Është vetëm një dëshirë e tij në mbështetje dhe si një kandidaturë që mendon t'i ofrohet Partisë Socialiste meqenëse ka 5 vjet si nënkryetar i Bashkisë së Durrësit",- thekson Braho në këtë intervistë.*



Spartak Braho



Arbër Braho

**PROTESTA**

"E ndoqa protestën aq sa munda nëpërmjet ekranit të televizionit dhe ajo që mund të them lidhur me pyetjen tuaj është se ngjarjet e djeshme ishin fundi i një komedie me aktorë politikë që bllofuan se do luanin tragjeditë e Eskilit."

**Zoti Braho, opozita protestoi dje për rreth 5 orë para Kryeministrisë ku nuk munguan as aktet e dhunës sidomos ndaj godinës. Keni ju një koment, si i patë ngjarjet e ndjeshme?**

E ndoqa protestën aq sa munda nëpërmjet ekranit të televizionit dhe ajo që mund të them lidhur me pyetjen tuaj është se ngjarjet e djeshme ishin fundi i një komedie me aktorë politikë që bllofuan se do luanin tragjeditë e Eskilit.

**Duket se jemi në kushtet e njëjta me ato të para dy viteve, ku para zgjedhjeve të përgjithshme opozita pas disa protestave u ngujua në çadrën para Kryeministrisë. Nisur edhe nga paralajmërimi i opozitës për të vijuar sërish të enjten protestën, çfarë duhet të bëjë mazhoranca tani?**

Mazhoranca do vazhdojë të qeverisë deri 2026 me këtë opozitë që çdo 6 muaj "vret veten", por pa mendjemadhësi.

**Ndërkohë që kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha deklaroi dje se do i propozojë grupit parlamentar të forcës që vet drejton që të djegë mandatet e deputetëve të saj si një masë ekstreme për të detyruar qeverinë që të pranojë kërkesat e opozitës për krijimin e një qeverie tranzicioni dhe për të shkuar në zgjedhje të parakohshme. Si e komentoni këtë vendim të pritshëm të PD-së dhe si do ndikojë ajo në situatën politike në vend?**

E para mandatet nuk i kanë personale. Jua ka dhënë populli dhe s'mund të tallen. Do të jetë një vetëvrasje tjetër në kushtet e dëshpërimit. Në dëshpërim njeriu vetekzekutohet. Po jeta parlamentare vazhdon edhe më pas pasi mazhoranca i ka 80 deputetë. Por ka edhe diçka tjetër: akrepi kur bie në fund të tasit e nuk del dot i ngul helmin e vdekjes dhe i jep fund. Kështu do t'i ndodhë edhe të ashtuquajturës opozitë. Ajo vetpërjashtohet nga strukturat parlamentare. Fshihet dhe s'ka më të drejtë të propozojë as një amendament ligjor, s'ka më të drejtë të llogarisë strukturat elektorale, komisionerë dhe prapë votat do ia numërojnë të tjerët. E kupton sa të marrë janë. Adio opozitë.

**A ka vend për një marrëveshje të re mes mazhorancës dhe opozitës si ajo e 17 majit?**

Marrëveshje duhet të ketë vetëm për të miratuar ndryshimet në Kodin Zgjedhor dhe reformën në drejtësi.

**PER OPOZITEN**

"Akrepi, kur bie në fund të tasit e nuk del dot, i ngul helmin e vdekjes dhe i jep fund. Kështu do t'i ndodhë edhe të ashtuquajturës opozitë. Ajo vetpërjashtohet nga strukturat parlamentare" - tha deputeti socialist.

**Zoti Braho, para pak javësh kryeministri Edi Rama riformatoi kabinetin e tij qeveritar duke ndryshuar më shumë se gjysmën e ministrave duke i zëvendësuar me emra kryesisht të panjohur. Si i shihni këto ndryshime dhe faktin që janë shmangur përfshirja e emrave dhe politikanëve të karrierës në PS?**

Besoj se është shpejtë për të folur për ndryshimet në qeveri. Kanë kaluar vetëm pak javë nga momenti që ministrat e rinj kanë marrë detyrat e tyre. Të marrin veten një herë dhe të kuptojnë detyrat që duhet të kryejnë.

**Dhe një pyetje për zgjedhjet në Durrës. Emri djalit tuaj është folur si një kandidat i mundshëm për Bashkinë e Durrësit për zgjedhjet e ardhshme vendore. A është ai, në fakt, një emër që po diskutohet edhe në strukturat e PS-së në Durrës për të qenë kandidat për kryetar bashkie në zgjedhjet e ardhshme të 30 qershorit?**

Jo, është vetëm një dëshirë e tij në mbështetje dhe si një kandidaturë që mendon t'i ofrohet Partisë Socialiste meqenëse ka 5 vjet si nënkryetar i Bashkisë së Durrësit.

### Deputetët

**PËR MANDATET**
"Do të jetë një vetëvrasje tjetër në kushtet e dëshpërimit. Në dëshpërim njeriu vetekzekutohet. Po jeta parlamentare vazhdon edhe më pas pasi mazhoranca i ka 80 deputetë."

### Detyrat

**PËR QEVERINË**
"Kanë kaluar vetëm pak javë nga momenti që ministrat e rinj kanë marrë detyrat e tyre. Të marrin veten një herë dhe të kuptojnë detyrat që duhet të kryejnë."

### Kandidimi

**PËR DJALIN**
"Jo, është vetëm një dëshirë e tij në mbështetje dhe si një kandidaturë që mendon t'i ofrohet Partisë Socialiste meqenëse ka 5 vjet si nënkryetar i Bashkisë së Durrësit"

**Njoftim për shitje me ankand te III**

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k ka shpallur ne date 11.02.2019 ankandin e trete të pasurisë të palës debitore Sh "Stati Construction " sh.p.k dhe e pales dorezanese, e përbërë nga :
"Are ", me numer pasurie 172/23 ne Zonen Kadastrale Nr. 1522, volumi 3, faqe 249, Ankandi fillon me çmim fillestar në masën 2.016.000 lekë
"Apartament ", me numer pasurie 116/61-1-19 Zonen Kadastrale Nr. 2291, volumi 22, faqe 42, , Ankandi fillon me çmim fillestar në masën 957.600 lekë
"Apartament ", me numer pasurie 116/61-1-20 Zonen Kadastrale Nr. 2291, volumi 23, faqe 43, Ankandi fillin me çmim fillestar në masën 1.713.600 lekë
Ankandi do të zhvillohet në datë 13.03.2019 ora 15:00 në selinë Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr.5 Kontakt tel. 0672082543, ilir_dervishaj@yahoo.com, WEB www.powerjustice-al.com.

**Njoftim për shitje me ankand te III**

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k ka shpallur ne date 11.02.2019 ankandin e trete të pasurisë të palës debitore Shoqëria "G P R A" sh.p.k, e përbërë nga :
Pasurie Nr.31/33, ne Z K Nr. 2255, volum nr.5, faqe 235, me siperfaqe totale 7033 m2, ne Koxhas, Durres Ankandi i III fillon me çmim fillestar ne masen 103.077, 09 Euro.
Pasurie Nr.31/4, ne Z K Nr. 2255, volum nr.1, faqe 212, me siperfaqe totale 12 900 m2, ne Koxhas, Durres. Ankandi i III fillom me cmim fillestar ne masen 189.066,5 Euro .
Pasurie Nr.31/3, Z Ke Nr. 2255, volum nr.1, faqe 219, me siperfaqe totale 4 300 m2, ne Koxhas, Durres Ankandi i III fillon me çmimin fillestar ne masen. 63.022,1 Euro.
Ankandi do të zhvillohet në datë 13.03.2019 ora 15:00 në selisë Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr.5 Kontakt tel. 0672082543, ilir_dervishaj@yahoo.com, WEB www.powerjustice-al.com.

Shpëton Armando Sulejmani, vdesin Aurest Rexho dhe Arjan Hasani

# Krim i dyfishtë në Vlorë, Vriten miqtë e "Çipurit"

## Ngjarja në mes të ditës, dyshohet hakmarrje

**NGJARJA**
Sulejmani ndodhej në pjesën e pasme në makinë me kunatin e tij, Aurest Rexho dhe shokun Arjan Hasani. Makina me të cilën lëviznin është qëlluar me kallashnikov nga një makinë tjetër dhe për t'i shpëtuar plumbave, shoferi (një prej viktimave) ka kthyer makinën djathtas duke e futur në oborrin e një banese, por ka qenë vonë për të dhe pasagjerin e parë.

Enrik Mehmeti

**VLORË**

Krim i rëndë në Vlorë. Dy persona janë ekzekutuar me armë zjarri, ndërsa një tjetër ka mbetur i plagosur. Ngjarja në zonën e "Ujit të Ftohtë në Vlorë" në rrugën e kthimit nga bregdeti. Mësohet se të vrarë kanë mbetur shtetasit Aurest Rexho dhe Arjan Hasani. Ndërsa i plagosur ka mbetur shtetasi Armando Sulejmani, 42 vjeç, i cili dyshohet se ka qenë dhe shënjestra e atentatit për shkak të të kaluarës së tij dhe precedentëve. Sulejmani ndodhej në pjesën e pasme në makinë me kunatin e tij, Aurest Rexho dhe shokun Arjan Hasani. Makina me të cilën lëviznin është qëlluar me kallashnikov nga një makinë tjetër dhe për t'i shpëtuar plumbave, shoferi (një prej viktimave) ka kthyer makinën djathtas duke e futur në oborrin e një banese, por ka qenë vonë për të dhe pasagjerin e parë. Sulejmani ka marrë plagë, por është jashtë rrezikut për jetën. Një prej viktimave u gjet i shtrirë në tokë, i mbuluar pranë murit të një banese. Ndërsa brenda oborrit të banesës është viktima i dytë brenda një makine tip "Volkswagen".






Policia ka shkuar në vendin e ngjarjes dhe ka nisur hetimet, ndërsa ka ngritur postblloqe në disa pika për kapjen e autorëve. Ndërkaq raportohet se autorët në ikje dogjën makinën në fshatin Shërisht. Mësohet se Sulejmani i akuzuar për vrasje ishte dënuar me 20 vite burg, por kishte dalë në vitin 2016. Ndaj dyshohet se krimi i sotëm ka si motiv hakmarrjen.

**DËSHMITARËT**

"Ç'po na shohin sytë, o zot, mbetën duke u vrarë njerëzit në mes të ditës. Na u tmerruan fëmijët nga kallashët", thotë duke u dridhur një grua, e cila ende dridhet nga skena që pa pranë shtëpisë së saj. Në fakt, të gjithë banorët e lagjes "Uji i Ftohtë" në Vlorë janë terrorizuar nga të shtënat e shumta. Disa prej tyre ia kanë vënë 'fajin' dasmave. Kështu tha për 'Gazeta Shqiptare' një banor. Ai rrëfeu se kanë qenë shumë të shtëna që janë dëgjuar edhe në largësi. "Unë jetoj atje lart, por i dëgjuam të shtënat, na than u vranë, erdhëm vrap. U dëgjuan shumë plumba, shumë fishekë. Thamë se ishte dasmë njëherë. Thamë po hedhin fishekzjarrë. Unë rri atje lart. Pas çerek ore kam ardhur këtu",-tregoi banori.

Gratteri: Grupet kriminale, që drejtohen nga shqiptarët, aftësi bashkëpunuese të mira

# "Mafia shqiptare në rritje, e egër dhe aleate me Ndrangheta-n"

**ITALI**-Mediat europiane kanë pasqyruar vazhdimisht jetën e shqiptarëve, kryesisht jetën e atyre të cilët janë pikasur në veprimtari të paligjshme. "Mafia shqiptare është e egër, e fortë dhe aleate me Ndragheta-n dhe po fiton terren çdo ditë dhe më shumë". Kështu ka deklaruar prokurori italian i Catanzaro-s, Nicola Gratteri, i cili ka folur për krimin dhe veprimtarinë e paligjshme të grupeve shqiptare.

Mes tjerash, prokurori ka theksuar se grupet kriminale, që drejtohen nga shqiptarët kanë aftësi bashkëpunuese shumë të mira me grupe të vendeve të tjera. Por bashkëpunimet janë të vazhdueshme edhe me grupime të tjera kriminale siç e tregon edhe menaxhimi i kokainës së rrugës që kontrollohet nga Ndragheta, mafia nigeriane apo grupet kriminale lokale", thekson ai.

Disa ditë më parë, të dy vendet Italia dhe Shqipëria në koordinim të plotë bën të mundur shkatërrimin e katër grupeve kriminale dhe arrestimin e 27 personave në




kuadër të operacionin "Lulet e Pranverës".

Në mesin e të arrestuarve, 21 ishin shqiptarë dhe 6 shtetas italianë. Këto grupe bazën kryesore e kishin në qytetin e Leces, por veprimtaria e tyre ishte e shtrirë në disa zona të Italisë. Ata gjithashtu synonin edhe tregun europian të shitjes së drogës dhe armëve.

**Shitje me Ankand te dyte nga Studio Permbarimore L.D.C**

***-"Truall + ndertese" me nr. pasurie 286/5/1, vol.3, faqe 36, Zona Kadastrale. 3866, me siperfaqe totale 300 m2, regjistruar ne Z.V.R.P.P. Tirane*. Çmimi fillestar per shitje eshte 2.175.096 Leke.**

Data e shpalljes **22.01.2019**
Data e zhvillimit **21.02.2019 deri ne oren 16.00**
**Ankandi zhvillohet ne ambjentet e Studios Permbarimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**SHËRBIMI INFORMATIV I SHTETIT**

**NJOFTIM**

Shërbimi Informativ i Shtetit kërkon të punësojë shtetas, të cilët pas konkurrimit do t'i nënshtrohen dhe një trajnimi.

Nevojat e SHISH janë fokusuar në:

1. Inspektorë terreni në njësitë e SHISH, jashtë Tiranës.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e poshtëshënuara:**

- Të jenë shtetas shqiptarë;
- Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të kenë mbaruar arsimin e lartë;
- Të jenë deri në moshën 35 vjeç;
- Të jenë të aftë nga ana shëndetësore;
- Të kenë njohuri të mira në gjuhën angleze, apo gjuhë të tjera, (preferohen kandidatë me njohje shumë të mirë të gjuhëve të huaja).
- Të kenë njohuri për programet bazë të kompjuterit;
- Të kenë dëshmi të pastër penaliteti dhe të mos kenë implikime me organet e drejtësisë;

**Të interesuarit të paraqiten pranë Drejtorive të SHISH në rrethe si dhe pranë Shërbimit Informativ te Shtetit në Aparatin Qendër, deri në datën 20.03.2019, me dokumentet e mëposhtme:**

- Kërkesë për punësim;
- Curriculum Vitae, (nr.tel. fix ose celular);
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Fotokopje të noterizuar të diplomës së shkollës së lartë dhe listës së notave;
- Certifikatë familjare;
- Vërtetim nga Prokuroria e rrethit përkatës;
- Vërtetim nga Gjykata e rrethit përkatës;
- Vërtetim nga Zyra Përmbarimore e rrethit përkatës;
- Raport mjeko-ligjor ;
- Certifikatë apo dëshmi për gjuhën e huaj nga Fakultetet e Gjuhëve të Huaja;
- Fotografi 4x6 (4 copë) dhe 9x12 (2 copë).

Vrau Ferdinand Llanajn e u dënua 20 vjet, ja shënjestra e vrasësve

# E shkuara Armando Sulejmanit, nga banda e Gaxhait te burgu

## Çipuri i shpëtoi dy atentateve më 2016 dhe 2019

Enrik Mehmeti

VLORË

Armando Sulejmani, ka mbetur i plagosur sot gjatë atentatit në zonën e Ujit të Ftohtë në Vlorë. Por Sulejmani është një emër i njohur për policinë pasi në vitin 2016 i ka shpëtuar një tjetër atentati. Ai njihet ndryshe dhe me nofkën "Çipuri" dhe dyshohet se ka qenë anëtari bandës së Gaxhait. Gazetari Enrik Mehmeti raportoi se Sulejmani ka qenë sot në makinë me kunatin e tij Aurest Rexho dhe shokut Arjan Hasani i njohur me nofkën "Lani".

**ATENTATI NË 2016**

Atentati ndaj Sulejmanit ndodhi më 23 maj të viti 2016 në lagjen "Pavarësia" të Vlorës ku 42-vjeçari u plagos me një plumb në krah në hyrje të pallatit ku jetonte. Policia tha atë kohë se autorët e atentatit ishin vrasës me pagesë, por jo profesionistë. Gjatë marrjes në pyetje, 39-vjeçari ka deklaruar se nuk i ka njohur personat që i bënë atentat, pasi ata kanë qenë të maskuar. Ndërkohë, ai nuk ka pranuar se ka pasur armë zjarri dhe se nuk ka qëlluar në drejtim të atentatorëve. Nga ana tjetër, burime nga policia bënë me dije se ishte qëlluar me armë zjarri pistoletë nga të dyja palët. Po të njëjtat burime sqaruan se dy autorët e krimit kanë qëlluar Armando Sulejmanin (kishte pak kohë që kishte dalë nga burgu) në hyrje të pallatit të tij dhe se ky i fundit, edhe pse i plagosur, ka mundur të ngjitet në katin e katërt dhe të kundërpërgjigjet ndaj atentatorëve me pistoletë. Mendohet se njëri nga atentatorët mund të jetë plagosur në këmbë. Pas verifikimit të kamerave të sigurisë në disa njësi tregtare të zonës, policia e Vlorës ka konstatuar se në atentatin ndaj Sulejmanit kanë marrë pjesë dy persona të moshës nga 20 deri në 25 vjeç, të maskuar dhe të armatosur me pistoletë. Nisur nga fakti se njëri nga autorët çalonte në të ecur, blutë deklaruan se ai mund të jetë plagosur. Policia dyshonte se ngjarja kishte ndodhur për larje hesapesh dhe se kishte lidhje me vrasjet e kryera nga Armando Sulejmani në të shkuarën e tij. Fillimisht Sulejmani është dënuar me 25 vite burg nga Gjykata e Krimeve të Rënda, ndërsa Gjykata e Lartë ia ka ulur dënimin duke e dënuar me 16 vite burg. Armando Sulejmani ka qenë i dyshuar për atentatin ndaj Ferdinand Llanajt, akuzë për të cilën u dënua fillimisht me 20 vite burg.



Vendi ku ndodhi vrasja


Armando Sulejmani

**DESHMIA**

Atentati ndaj Sulejmanit ndodhi më 23 maj të viti 2016 në lagjen "Pavarësia" të Vlorës ku 42-vjeçari u plagos me një plumb në krah në hyrje të pallatit ku jetonte. Policia tha atë kohë se autorët e atentatit ishin vrasës me pagesë, por jo profesionistë. Gjatë marrjes në pyetje, 39-vjeçari ka deklaruar se nuk i ka njohur personat që i bënë atentat, pasi ata kanë qenë të maskuar.

## GOMONIA 'PERBINDESH' NE VLORE




**Një gomone e fuqishme është zbuluar nga policia pak pas mesditës së sotme në grykëderdhjen e Vjosës. Gomonia me dy motorë të fuqishëm ishte fshehur në grykëderdhje. Sipas policisë, dyshohet se mjeti do përdorej për transport të lëndëve narkotike. Nisur nga disa precedentë të kësaj natyre, policia thotë se gomonia e kapur sot ishte më e madhja e kapur kohët e fundit. Ndërkohë policia po kryen hetime për të gjetur pronarët e mjetit ujor.**

**PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk**

Njofton se duke filluar nga data 25 shkurt 2019 çmimi maksimal i shitjes me pakicë për 1 paketë për produktet e mëposhtme është si vijon:

| Përshkrimi i Produktit | Çmimi prej datës 25.02.2019 (përfshirë TVSh-në) |
|---|---|
| MARLBORO PREMIUM BLACK KS BOS 20 | 500 Lekë/paketë |
| MARLBORO GOLD (2.0 ORIGINAL) KS LCB 20 | 320 Lekë/paketë |
| MARLBORO GOLD (2.0 ORIGINAL) KS BOX 10 | 320 Lekë/paketë |
| MARLBORO (RED FWD) KS BOX 20 | 320 Lekë/paketë |
| MARLBORO (RED FWD) KS BOX 10 | 320 Lekë/paketë |
| MARLBORO FLAVOR PLUS (FWD) KS SRP 20 | 320 Lekë/paketë |
| MARLBORO TOUCH (4 MG) KS RCB 20 SLI | 300 Lekë/paketë |
| MARLBORO TOUCH (6 MG) KS RCB 20 SLI | 300 Lekë/paketë |
| MARLBORO TOUCH XL (2.0) 100 RCB 20 XSL | 300 Lekë/paketë |
| MARLBORO TOUCH XL (2.5) 100 DSP 20 SSL | 280 Lekë/paketë |
| PHILIP MORRIS QUANTUM SUPREME KS BOX 20 | 260 Lekë/paketë |
| PHILIP MORRIS QUANTUM SUPREME KS RCB 10 | 260 Lekë/paketë |
| PHILIP MORRIS SLIMSMAG 100 RCB 20 XSL | 240 Lekë/paketë |
| PHILIP MORRIS COMPAC6M KS RCB 20 SLIMS | 240 Lekë/paketë |
| PHILIP MORRIS COMPAC4 KS RCB 20 SLIMS | 240 Lekë/paketë |
| MERIT BIANCA 100 BOX 20 SSL | 220 Lekë/paketë |
| MERIT (ORANGE) KS RCB 20 | 230 Lekë/paketë |
| L&M RED LABEL KS RCB 20 | 220 Lekë/paketë |
| L&M LOFT 4MG RCB 20 | 220 Lekë/paketë |
| L&M LOFT 6MG RCB 20 | 220 Lekë/paketë |

Njoftimi bëhet në përputhje me Udhëzimin nr. 2, datë 28.1.2010 të Ministrisë së Financave "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 'Për tatimin mbi vlerën e shtuar'" (i ndryshuar).

**PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk**

Rr. Murat Toptani , Qendra e biznesit Eurocol, Kati i 10,
1000 Tirana, Albania
Tel: +355 42 276 670

Ngjarja në Selanik mes shqiptarësh. Çfarë thotë policia

# Djali vret të atin, historia mes tyre

## *Policia: E gjetëm në një shesh lojërash*

Një 45-vjeçar me kombësi shqiptare u gjet i vdekur dje pasdite në fshatin Agios Athanasios të Selanikut. Trupi i pajetë i 45-vjeçarit u konstatua pranë një sheshi lojërash, ngjitur me aksin rrugor kryesor të fshatit. Hetimi policor zbuloi se krimi është kryer nga djali. Sipas thestival.gr, 20-vjeçari pas rrëfimit të ngjarjes në polici ka treguar se babanë e ka goditur në vendin ku u gjet i vdekur nga autoritetet greke. Vdekja ka ardhur pas një grindjeje babë e bir, madje mes tyre u futen edhe dy persona për t'i ndarë, por ky mision ishte i pamundur. Sipas të dhënave të para të mjekësisë ligjore thuhet se trupi i shqiptarit ka pësuar trauma të forta, madje edhe thyerje të hundës. Do të vijojnë hetimet për të sqaruar shkaqet që çuan në vdekjen e 45-vjeçarit, ndërkohë që autori tashmë është arrestuar. Mediat greke raportojë se djali ka rrahur egërsisht babanë deri në vdekje, por hetimet dhe autopsia do të përcaktojnë përfundimisht shkakun e vdekjes së 45-vjeçarit.

**NGJARJA**

Krimi i egër në Selanik. Një 45-vjeçar shqiptar, u gjet i vdekur në një pellg gjaku pasditen e së shtunës në fshatin Agios Athanasios të Selanikut. Trupi i pajetë i 45-vjeçarit u gjet pranë një sheshi lojërash, ngjitur me aksin rrugor kryesor të fshatit. Fytyra e tij kishte plagë të shumta. Kjo ishte arsyeja kryesore që i bëri autoritetet që në fillim të dyshonin se kishin të bënin me një vrasje. Vendi i ngjarjes u bllokua nga forcat e policisë. Policia e Departamentit të Krimit të Jetës në Drejtorinë e Sigurisë së Selanikut ka mbledhur të dhëna që do të ndihmojnë në zbulimin e identitetit të sulmuesit të vrasjes. Sipas informacionit ekskluziv të thestival.gr, dyshimet e para të policisë janë se vrasjen mund ta ketë kryer djali i viktimës. Një çast më vonë, pas zbulimit të trupit të 45-vjeçarit, oficerët e policisë shoqëruan të birin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Selanikut për ta marrë në pyetje. Në këtë rast dëshmitare është një grua e re shqiptare që pretendohet se ka parë atë që ndodhi pranë sheshit të lojërave. Zougla.gr




**NGJARJA NE GREQI**

Krimi i egër në Selanik. Një 45-vjeçar shqiptar, u gjet i vdekur në një pellg gjaku pasditen e së shtunës në fshatin Agios Athanasios të Selanikut. Trupi i pajetë i 45-vjeçarit u gjet pranë një sheshi lojërash, ngjitur me aksin rrugor kryesor të fshatit. Fytyra e tij kishte plagë të shumta. Kjo ishte arsyeja kryesore që i bëri autoritetet që në fillim të dyshonin se kishin të bënin me një vrasje.

# Identifikohet aksidentuesi i 24-vjeçarit, ja çfarë ndodhi

Policia e Elbasanit ka identifikuar dhe ndaluar autorin e dyshuar të aksidentit me pasojë vdekjen e një 24-vjeçari të ndodhur më 13 shkurt 2019. Specialistët e Policisë Rrugore në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, pas një pune të mirëorganizuar hetimore, bazuar në provat shkencore të grumbulluara bënë identifikimin dhe ndalimin me iniciativë të autorit të dyshuar të aksidentit me pasojë vdekjen e shtetasit G.H., ndodhur më 13 shkurt 2019 në aksin rrugor Elbasan- Metalurgji, në fshatin Katund i Ri, ku pas aksidentit drejtuesi i mjetit u largua nga vendi i ngjarjes. Policia ka ndaluar shtetasin me iniciale H.P., 51 vjeç, banues në Elbasan. Nga veprimet e mëtejshme hetimore të kryera, u proceduan penalisht në gjendje të lirë dhe dy shtetas, për veprat penale "Moskallëzim krimi" dhe "Kallëzim i rremë". Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan, për veprime të mëtejshme.




**NDALIMI**

Specialistët e Policisë Rrugore në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, pas një pune të mirëorganizuar hetimore, bazuar në provat shkencore të grumbulluara bënë identifikimin dhe ndalimin me iniciativë të autorit të dyshuar të aksidentit me pasojë vdekjen e shtetasit G.H., ndodhur më 13 shkurt 2019 në aksin rrugor Elbasan- Metalurgji, në fshatin Katund i Ri, ku pas aksidentit drejtuesi i mjetit u largua nga vendi i ngjarjes. Policia ka ndaluar shtetasin me iniciale H.P., 51 vjeç, banues në Elbasan.

**Policia: Të rinjtë nga Shqipëria**

# Greqi, 8 kg marijuanë në Igumenicë, si u zbuluan

Policia greke ka zbuluar 8 kg marijuanë në stacionin e autobusëve në Igumenicë. Mësohet se droga iu gjet dy shqiptarëve 22 dhe 31 vjeç, të cilët u arrestuan. Ata u ndaluan para se të hipnin në autobusin e linjës Igumenicë-Athinë. Droga ishte e ndarë në 4 pako me peshë gjithsej 7 kg 990 gram. Policia sekuestroi, gjithashtu, dhe 2 celularë. Dy shqiptarët kishin kaluar ilegalisht nga kufiri i gjelbër.

Mësohet se droga iu gjet dy shqiptarëve 22 dhe 31 vjeç, të cilët u arrestuan. Ata u ndaluan para se të hipnin në autobusin e linjës Igumenicë-Athinë.



## Haradinaj: Viti i konsolidimit si shtet, mbyllim temat e hapura

# Kryeministri kosovar: Së shpejti do të ketë marrëveshje në kufijtë ekzistues, dhe hyrje në NATO

Ditën e djeshme qeveria e Kosovës mbajti një mbledhje solemne për nder të 11-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Kryeministri Ramush Haradinaj, me këtë rast mbajti një fjalim të shkurtër para kabinetit qeveritar ku tha se secili qytetar i Kosovës e ka rrëfimin e tij për rrugëtimin e shtetit të Kosovës për këto 11 vjet. "Pavarësia jeton në ne. Secili prej nesh i ka rrugëtuar këto 11 vjet të Pavarësisë, çdo qytetar, secili prej nesh e ka rrëfimin e vet të rrugës së 11 vjetëve të shtetit. Edhe qeveria e vendit e ka rrëfimin e vet. Edhe kjo qeveri tani e ka rrëfimin e vet nga koha kur kemi marrë përgjegjësitë. Ajo që mendoj se është me rëndësi t'ua konfirmojmë qytetarëve të vendit është se me kujdesin më të madh jemi përballur me të gjitha çështjet që kanë ndodhur para Kosovës dhe Qeverisë dhe njëkohësisht me respektin më të madh për interesin e qytetarëve të vendit. Ka shumë vendime, ligje, pako ligjore, reformë. Ka gjithashtu vendime të mëdha si Ushtria, vendimet që lidhen me Trepçën dhe resurset tjera ekonomike- vendime të tjera ekonomike", deklaroi Haradinaj. Ai ka thënë se viti 2019 do të jetë viti kur Kosova do t'i përmbyllë të gjitha çështjet e hapura, duke përmendur edhe marrëveshjen finale me Serbinë. "Në 10 vjetëshin e dytë që kemi hyrë, besoj që është një vit i konsolidimit tonë si shtet dhe i përmbylljes së të gjitha temave të mbetura të hapura në planin rajonal dhe ndërkombëtar, që nënkupton edhe marrëveshje për njohje obligative ligjore me Serbinë në kufijtë ekzistues, njëkohësisht edhe anëtarësimin në NATO".

**RAMUSH HARADINAJ**
"Pavarësia jeton në ne. Secili prej nesh i ka rrugëtuar këto 11 vjet të Pavarësisë, çdo qytetar, secili prej nesh e ka rrëfimin e vet të rrugës së 11 vjetëve të shtetit. Edhe qeveria e vendit e ka rrëfimin e vet. Edhe kjo qeveri tani e ka rrëfimin e vet nga koha kur kemi marrë përgjegjësitë," tha ndër të tjera Haradinaj.



## Thaçi: Shpallja e Pavarësisë institucionalizoi përpjekjet për liri

# Kosova festoi pavarësinë, 11 vite shtet

## *Pompeo dhe politikanët shqiptarë urojnë kosovarët*




Ditën e djeshme, me aktivitete të ndryshme është shënuar 11-vjetori i Pavarësisë në Kosovë. Parakalimi i ushtrisë për herë të parë me mision ushtarak ishte e veçanta e këtij përvjetori. Ngritja e flamurit shtetëror të Kosovës që në mëngjes ka shënuar nisjen e aktiviteteve për nder të 11-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës. E veçanta e këtij përvjetori ishte parakalimi i ushtrisë së Kosovës për herë të parë me mision ushtarak. Kujtojmë pak nga historiku i këtij vendi se zanafilla e kësaj dite vjen ka çështja e qytetit të ndarë të Mitrovicës si dhe provokimet e qarqeve ekstremiste serbe të cilat sollën protesta të dhunshme në vitet 1999 dhe 2000. Ato shkaktuan trazirat e marsit 2004, të cilat dëmtuan imazhin ndërkombëtar të Kosovës. Formimi i enklavave serbe në mes të Kosovës dhe përqendrimi serb në veri vazhdonte të pengonte kthimin e të zhvendosurve, shqiptarë dhe serbë. Bisedimet për statusin final të Kosovës ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit rezultuan pa marrëveshje. Kompromisi i ofruar nga pala kosovare parashihte Kosovën si shtet të pavarur shumetnik, si pikë në mes të bashkimit me Shqipërinë ose mbetjen nën Serbi, kurse pala serbe propozoi disa versione të ndryshme për autonomi. Kombet e Bashkuara, në ndërkohë, dërguan përfaqësues të tyre ish-kryetarin finlandez Martti Ahtisaari, i cili nxori më 2007 Planin Gjithëpërfshirës, ku parashihej pavarësi e mbikëqyrur me të drejta të zgjeruara për pakicat, sidomos serbët. Në bazë të këtij plani dhe duke u thirrur në Rezolutën 1244, Kuvendi i Kosovës shpalli pavarësinë më 17 shkurt 2008. Kostarika dhe Afganistani ishin vendet e para që e njohën pavarësinë e Kosovës, të përcjella nga Shqipëria, SHBA-të, Britania, Gjermania dhe Franca. Kushtetuta e Republikës u miratua më 9 prill 2008 dhe hyri në fuqi më 15 qershor 2008, kur edhe u bë transferimi i plotë i kompetencave prej UNMIK-ut në institucionet vendore. Gjithashtu, u nënshkrua më 9 shkurt 2008 marrëveshja me Bashkimin Evropian, EULEX, si dhe u parapa themelimi i Zyrës Civile Ndërkombëtare. Ditën e djeshme presidenti Hashim Thaçi tha se pas 11 vjetësh të Pavarësisë, kemi një ushtri multietnike në shërbim të qytetarëve të Kosovës. Në ceremoni përveç krerëve shtetërorë të Kosovës mori pjesë edhe kryeministri i Shqipërisë Edi Rama. Para ceremonisë nuk u vërejt ndonjë shtrëngim duarsh ndërmjet Kryeministrit shqiptar dhe atij kosovar. Qeveria paradite mbajti mbledhje solemne për të vazhduar më pas edhe senca solemne e Kuvendit të Kosovës. Për 11-vjetorin e Pavarësisë popullin e Kosovës e kanë uruar krerët e vendeve të ndryshme të botës dhe ambasadorët e akredituar në Kosovës. Liderët institucionalë kanë vendosur kurora lulesh te shtatorja e ish-Presidentit Ibrahim Rugova. Homazhe janë bërë edhe në kompleksin memorial "Adem Jashari" në Prekaz. Edhe pse ishin bashkë në homazhe, Presidenti Thaçi e kryeministri Haradinaj u ndanë për pak çaste ku ky i fundit vizitoi kullën e Jasharajve. Në kuadër të kësaj dite, në shtatë qendra të Kosovës është nisur Deklarata e Pavarësisë. Një e tillë është vendosur edhe në sheshin "Nënë Tereza" në Prishtinë. Nisja e Deklaratës së Pavarësisë në qendrat e Kosovës u bë nga Garda Ceremoniale. Deklarata e Pavarësisë është nisur për në qytetin e Mitrovicës, Gjakovës, Prizrenit, Gjilanit, Pejës dhe Ferizajt. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se shpallja e Pavarësisë së Kosovës para njëmbëdhjetë vjetëve ishte akti historik më sublim që institucionalizoi përpjekjet për liri. Thaçi, përmes një postimi në 'Facebook', ka thënë se për këto arritje janë të gjithë qytetarët kontribues. "Shpallja e Pavarësisë së Kosovës para njëmbëdhjetë vjetëve ishte akti historik më sublim që institucionalizoi përpjekjet tona për liri. Për këtë të arritur të gjithë qytetarët tanë janë meritorë. I falënderojmë të gjithë miqtë tanë, në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që kontribuan për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. U jemi mirënjohës përjetë! HTH", ka shkruar Thaçi. Ndërkaq sekretari amerikan i shtetit, Mike Pompeo, i ka uruar të gjithë qytetarët e Kosovës për përvjetorin e 11-të të pavarësisë së vendit, ndërsa bëhet i dyti zyrtar i lartë amerikan që flet qartë për njohjen reciproke të Kosovës nga Serbia, pas presidentit të SHBA-ve Donald Trump. "Normalizimi gjithëpërfshirës i marrëdhënieve me Serbinë, me njohjen reciproke si pjesë qendrore të tyre, do të jetë proces jetik për suksesin e Kosovës", thotë Pompeo. Në letrën e publikuar në faqen zyrtare të Departamentit të Shtetit thuhet se SHBA-ja mbetet e përkushtuar për ta ndihmuar Kosovën në të ardhmen për më shumë prosperitet, siguri dhe stabilitet. "Në emër të qeverisë së Shteteve të Bashkuara dhe të popullit amerikan, e uroj Kosovën për përvjetorin e njëmbëdhjetë të shtetit të pavarur dhe sovran. Shtetet e Bashkuara mbesin të përkushtuara për ta ndihmuar Kosovën që t'i hapë dyert drejt së ardhmes me më shumë prosperitet, siguri dhe stabilitet në dekadën e dytë të pavarësisë. Normalizimi gjithëpërfshirës i marrëdhënieve me Serbinë, me njohjen reciproke si pjesë qendrore të tyre, do të jetë proces jetik për suksesin e Kosovës. Arritja e këtij vizioni kërkon zhvillime të vazhdueshme për t'i forcuar institucionet tuaja demokratike. Ne dëshirojmë ta vazhdojmë ndërtimin e partneritetit tonë dypalësh, të mbështetur në vlera dhe prioritete të përbashkëta, duke e ndihmuar Kosovën për ta shtruar rrugën e saj drejt integrimit të mëtejshëm në Evropë. Shtetet e Bashkuara e çmojnë lidhjen e fortë mes popujve tanë dhe do t'i mbështesin hapat e atyre që punojnë për ta nxjerrë në pah potencialin e madh të Kosovës",-shkruhet në urimin e Pompeos.

**SHKURT**

## Urimet e politikanëve shqiptarë:

**ILIR META**
Presidenti i Republikës Ilir Meta ka publikuar dje dy foto nga zyra e Kongresmenit amerikan Eliot Engel duke e cilësuar si një kujtim të paharrueshëm. Në foto Meta, shihet teksa sodit një kopje të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës në zyrën e kryetarit të Komisionit për Politikën e Jashtme në Kongresin Amerikan Eliot Engel. Duket se këtë foto Presidenti Meta e ka zgjedhur enkas dje në përvjetorin e Pavarësisë së Kosovës si një mesazh të qartë. "Një kujtim i paharrueshëm nga zyra e kongresmenit Eliot Engel",-shkruan kreu i shtetit në "Facebook".

**EDI RAMA**
Kryeministri Edi Rama e ka nisur ditën dje me një urim për Kosovën në 11-vjetorin e Pavarësisë. Ai ka zgjedhur një foto të flamurit kuqezi bashkangjitur flamurit të Kosovës, si një mesazh të qartë të urimit të tij. "MIRËMËNGJES dhe me urimin për ditëlindjen e shtetit të Kosovës, ju dëshiroj një të diel të bukur të gjithëve",-shkruan Rama.

Lulzim Basha:
"Dje në përvjetorin e 11 të Pavarësisë së Kosovës, arritjes së dytë më të madhe kombëtare të historisë së shqiptarëve, ju dërgoj një urim të përzemërt vëllezërve dhe motrave tona në Kosovë. Së bashku me urimin dje është dita për të kujtuar me krenari dhe mirënjohje të thellë kombëtare të gjithë ata që për dekada kanë punuar dhe sakrifikuar për këtë arritje. Le të shërbejë ky kontribut si amanet i madh për të gjithë ne dje, që me vendosmëri, përkushtim dhe qartësi strategjike, të vazhdojmë rrugëtimin e përbashkët në mbrojtje të fuqizim të pavarësisë, sovranitetit dhe vlerave e të ardhmes euroatlantike të Kosovës si interesi më i lartë kombëtar i shqiptarëve në Ballkan", shkruan Basha.

**MONIKA KRYEMADHI**
"Urime Kosovë! Teksa hyn në dekadën e dytë të pavarësisë e sovranitetit. Në këtë ditë të pavarësisë është detyrë e të gjithëve ne, lartësimi i figurave dhe luftëtarëve që kontribuuan dhe sakrifikuan edhe jetën për realizimin e këtij misioni epokal për Kosovën. Vlerësimet më të larta për qytetarët e Kosovës që të gjithë së bashku me të zgjedhurit e tyre konsolidojnë çdo ditë shtetin e lindur me aq mund. E ardhmja euroatlantike e Kosovës është një rrugë dhe aspiratë pa kthim dhe ne të gjithë do të jemi në krah të saj për përmbushjen e kësaj ëndrre të vëllezërve e motrave tona në Kosovë. Ta gëzosh përjetë këtë ditë të madhe Kosovë!", shkruan Kryemadhi.

**DITMIR BUSHATI**
Ish-ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme Ditmir Bushati ka uruar 11-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës nëpërmjet një statusi në "Facebook". Bushati thotë se Kosova shtet është produkt i sakrificës për liri, por edhe rendit ndërkombëtar. "Gëzuar ditën e pavarësisë Kosovë! Kosova shtet është produkt i sakrificës për liri dhe rendit ndërkombëtar të bazuar mbi respektin për të drejtat e njeriut. #Mirënjohje", shkruan Bushati.

**PANDELI MAJKO**
"Gëzuar përvjetorin e pavarësisë Kosovë…", shkruan Majko, ndërsa në foton e Jasharit shkruhet "Të gjithë dhanë diçka, por dikush i dha të gjitha", ka shkruar Majko.

Pikët e grumbulluara në pozicionin fizioterapist, mami e teknik laboratori e imazherie

# Zbardhen emrat e 400 fituesve që aplikuan në Infermierë për Shqipërinë

## *Lista e plotë për 6 qarqe në të gjithë vendin*

Voltiza Duro

Të gjithë ata që kanë aplikuar për një vend pune në portalin "Infermierë për Shqipërinë", tashmë mund të njihen me pikët që kanë mundur të grumbullojnë gjatë testimit. 'Gazeta Shqiptare' publikon sot emrat e 400 fituesve për 6 qarqe, përkatësisht atë të Tiranës, Durrësit, Lezhës, Shkodrës, Kukësit si dhe Dibrës. Respektivisht janë 96 fitues në fazën e parë për Fizioterapi, 163 kandidatë fitues për pozicionin Mami; 54 fitues në pozicionin Teknik Imazherie; si dhe 78 fitues në pozicionin Teknik Laboratori që aplikuan e u testuan në portalin "Infermierë për Shqipërinë". "Testimi do të bëhet në Godinën e Lëndëve Paraklinike (pas spitalit infektiv) Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, për të gjithë për të gjitha qarqet",-thekson Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ndërkohë pritet të zbardhen pikët që kanë grumbulluar kandidatët në Qarkun Elbasan, Qarkun Korçë, Qarkun Berat, Qarkun Fier, Qarkun Vlorë dhe Qarkun Gjirokastër në profilet Mami, Teknik laboratori, Teknik imazherie, Fizioterapist që u testuan në 17 shkurt.

### EMRAT E FITUESVE NE 6 QARQE

| Nr | Specialiteti | Qarku | Emër Atësi Mbiemër | Piket |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Fizioterapi | Diber | BERTOLD FLAMUR KECI | 35 |
| 2 | Fizioterapi | Diber | KLEVIS RIZA HYSA | 31 |
| 3 | Fizioterapi | Durres | AMARILDA KASTRIOT XHAFERRI | 48 |
| 4 | Fizioterapi | Durres | BLEDI SPIRO JOVANI | 36 |
| 5 | Fizioterapi | Durres | EDMOND PELLUMB CIKALLESHI | 21 |
| 6 | Fizioterapi | Durres | ENIS FATMIR PEKU | 29 |
| 7 | Fizioterapi | Durres | ERAND LULZIM DERJAJ | 40 |
| 8 | Fizioterapi | Durres | FLLANXA HALIL SHURBI | 33 |
| 9 | Fizioterapi | Durres | IRILDA SHKELQIM BRAHA | 40 |
| 10 | Fizioterapi | Durres | IRMA ILIR DEDEJ | 47 |
| 11 | Fizioterapi | Durres | ISIDA SOTIR CICI | 37 |
| 12 | Fizioterapi | Durres | KEANA SULEJMAN SULEJMANI | 33 |
| 13 | Fizioterapi | Durres | SILVANA RAMIZ MEHMETI | 38 |
| 14 | Fizioterapi | Durres | SILVI AGRON META | 35 |
| 15 | Fizioterapi | Durres | SILVIA XHEVAHIR SKAPI | 36 |
| 16 | Fizioterapi | Durres | SUELA AHMET BODLLI | 50 |
| 17 | Fizioterapi | Lezhe | ARISTEA PASHK GJERGJI | 39 |
| 18 | Fizioterapi | Lezhe | AURELA LEKE MARKU | 41 |
| 19 | Fizioterapi | Lezhe | ERJONA LEK MATA | 45 |
| 20 | Fizioterapi | Lezhe | SILVANA SANDER SHTJEFNI | 36 |
| 21 | Fizioterapi | Shkoder | ARMELINDA BASHKIM LULAJ | 31 |
| 22 | Fizioterapi | Shkoder | EDRA MEHMET KURTAJ | 45 |
| 23 | Fizioterapi | Shkoder | ERESTINA FRAN QEHAJA | 39 |
| 24 | Fizioterapi | Shkoder | ERLINDA GJON ZEFI | 26 |
| 25 | Fizioterapi | Shkoder | FATJON SHABAN BROCI | 38 |
| 26 | Fizioterapi | Shkoder | IZMIRA SHYQYRI KURTULAJ | 25 |
| 27 | Fizioterapi | Shkoder | MIRANDA NDUE GURI | 44 |
| 28 | Fizioterapi | Shkoder | ODENSA SULEJMAN MUSTAFA | 30 |
| 29 | Fizioterapi | Shkoder | OLTA FRANO LEKA | 39 |
| 30 | Fizioterapi | Tirane | ADELAJDA FLORENC KUTROLLI | 35 |
| 31 | Fizioterapi | Tirane | AJKUNA MYZAFER TELHAJ | 41 |
| 32 | Fizioterapi | Tirane | ALBAN LULZIM MERDANI | 43 |
| 33 | Fizioterapi | Tirane | ALTEO VLADIMIR PULA | 28 |
| 34 | Fizioterapi | Tirane | ANDI NEVRUZ MET-HASANI | 37 |
| 35 | Fizioterapi | Tirane | ANI NEXHMEDIN VERCANI | 25 |
| 36 | Fizioterapi | Tirane | ANXHELA ARISTIDH AVDULI | 53 |
| 37 | Fizioterapi | Tirane | ANXHELA EDMOND AHMATAJ | 42 |
| 38 | Fizioterapi | Tirane | ANXHELA AVDULLA SULO | 44 |
| 39 | Fizioterapi | Tirane | ANXHELA PETRIT BRUCI | 34 |
| 40 | Fizioterapi | Tirane | ARDIT ARESIM HILA | 25 |
| 41 | Fizioterapi | Tirane | BEHIJE HAMDI MARRA | 46 |
| 42 | Fizioterapi | Tirane | BORALDA FATMIR MYFTARAJ | 38 |
| 43 | Fizioterapi | Tirane | DAJANA ENVER VELIAJ | 51 |
| 44 | Fizioterapi | Tirane | DANIELA NESHAT NELAJ | 39 |
| 45 | Fizioterapi | Tirane | DENIS YLLI XHOXHAJ | 44 |
| 46 | Fizioterapi | Tirane | DOKLEJDA IDAJET LAMA | 38 |
| 47 | Fizioterapi | Tirane | DONALDA ASQERI KACELI | 43 |
| 48 | Fizioterapi | Tirane | EDLIRA ADRIATIK KALOSHI | 28 |
| 49 | Fizioterapi | Tirane | AGIM ABEDINI | 42 |
| 50 | Fizioterapi | Tirane | EGIR AGIM KERTUSHA | 31 |
| 51 | Fizioterapi | Tirane | ELENI ANDREA KOCO | 30 |
| 52 | Fizioterapi | Tirane | ELIS BAKI KUSHOVA | 38 |
| 53 | Fizioterapi | Tirane | ELIZABETA ZEF DODAJ | 54 |
| 54 | Fizioterapi | Tirane | ELJO ROBERT CAUSHI | 41 |
| 55 | Fizioterapi | Tirane | ELTON SHEFKI ALMADHI | 43 |
| 56 | Fizioterapi | Tirane | ENDRI VASIL PRIFTI | 38 |
| 57 | Fizioterapi | Tirane | ENSI NAZMI XHURXHI | 47 |
| 58 | Fizioterapi | Tirane | ENXHI ANDON BELLO | 56 |
| 59 | Fizioterapi | Tirane | ERALD ADRIAN PEPA | 32 |
| 60 | Fizioterapi | Tirane | ERIDA SHKELQIM BLOGU | 40 |
| 61 | Fizioterapi | Tirane | ESMERALDA LEFTER DAMA | 45 |
| 62 | Fizioterapi | Tirane | EVELINA QEMAL HOXHAJ | 37 |
| 63 | Fizioterapi | Tirane | FLONA ZENEL RAMA | 39 |
| 64 | Fizioterapi | Tirane | FLORENCA MIROSH SPAHIU | 49 |
| 65 | Fizioterapi | Tirane | FLORIDA QEREM BEQIRAJ | 44 |
| 66 | Fizioterapi | Tirane | ILDA NEAR LUMI | 40 |
| 67 | Fizioterapi | Tirane | IMIRJON KRISTAQ MISKA | 26 |
| 68 | Fizioterapi | Tirane | INDRIT PERLAT SMOKAJ | 53 |
| 69 | Fizioterapi | Tirane | IRDI FEJZI MULITA | 37 |
| 70 | Fizioterapi | Tirane | JASHAR PETRIT ZEQIRAJ | 31 |
| 71 | Fizioterapi | Tirane | JOLA FADIL XHARO | 53 |
| 72 | Fizioterapi | Tirane | JORIDA AJRET SHKULAKU | 53 |
| 73 | Fizioterapi | Tirane | KELSI VASIL NGJELA | 34 |
| 74 | Fizioterapi | Tirane | KLAUS ARTUR SHAQIRI | 45 |
| 75 | Fizioterapi | Tirane | KLEAD BASHKIM GJYLA | 45 |
| 76 | Fizioterapi | Tirane | KRISTOFOR THANAS HARITO | 21 |
| 77 | Fizioterapi | Tirane | LEONARD MUHAREM MECO | 35 |
| 78 | Fizioterapi | Tirane | LIRJAN GJERGJ ZEFI | 40 |
| 79 | Fizioterapi | Tirane | LOREDANA AGIM DUNGA | 48 |
| 80 | Fizioterapi | Tirane | MAJLINDA PRENG MARKU | 38 |
| 81 | Fizioterapi | Tirane | MARIA BESNIK BELALLA | 44 |
| 82 | Fizioterapi | Tirane | MARTA NAMIK LUZI | 38 |
| 83 | Fizioterapi | Tirane | MIRA NGJOLEK KAPAJ | 31 |
| 84 | Fizioterapi | Tirane | PRANVERA HAZBI AGO | 25 |
| 85 | Fizioterapi | Tirane | RAMIZ ISMET RECI | 39 |
| 86 | Fizioterapi | Tirane | ROMINA SKENDER HETA | 43 |
| 87 | Fizioterapi | Tirane | RUDINA ALFREDI KODRA | 50 |
| 88 | Fizioterapi | Tirane | SERXHO - PULI | 38 |
| 89 | Fizioterapi | Tirane | STELA FAZLLI MULLXHI | 33 |
| 90 | Fizioterapi | Tirane | TEDI KRISTAQ STRAKOSHA | 44 |
| 91 | Fizioterapi | Tirane | URIM MIT-HAT BALLA | 26 |
| 92 | Fizioterapi | Tirane | VALBONA MUHARREM NELA | 44 |
| 93 | Fizioterapi | Tirane | XHULIANA ASTRIT CESMALLI | 52 |
| 94 | Fizioterapi | Tirane | XHULIO ALEKSANDER RASPOPI | 25 |
| 95 | Fizioterapi | Tirane | XHULJA VALENTIN LULA | 45 |
| 96 | Fizioterapi | Tirane | XHULJAN FERIT KOLA | 40 |
| 97 | Mami | Berat | ANDIOLA ARBEN KUMARAKU | 51 |
| 98 | Mami | Berat | GERSJANA GEZIM PENXHO | 49 |
| 99 | Mami | Diber | ALFRIDA XHAFERR ISAKU | 43 |
| 100 | Mami | Durres | ABINA SKENDER DOKA | 39 |
| 101 | Mami | Durres | ANILA NDUE PRENGA | 37 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 102 | Mami | Durres | ARI THOMA SYLARI | 40 |
| 103 | Mami | Durres | ARJELA PELLUMB BLUSHI | 46 |
| 104 | Mami | Durres | AURORA KUJTIM VRAPI | 47 |
| 105 | Mami | Durres | AVIOLA VASIL PAPA | 44 |
| 106 | Mami | Durres | DESARA KUJTIM ZOGU | 31 |
| 107 | Mami | Durres | ELDA FATMIR DOKU | 38 |
| 108 | Mami | Durres | ESMA NDRICIM RAHI | 42 |
| 109 | Mami | Durres | ESMERALDA ELEZ DERVISHI | 45 |
| 110 | Mami | Durres | ESMERALDA GAZMEND SKONJA | 41 |
| 111 | Mami | Durres | FAZILE NDERIM ZAGRADI | 39 |
| 112 | Mami | Durres | ERDIJ TAHIR LELA | 34 |
| 113 | Mami | Durres | GRETA PANDELI PRIFTI | 35 |
| 114 | Mami | Durres | JONA TOMORR DRABO | 39 |
| 115 | Mami | Durres | JURGENA MITI LILA | 33 |
| 116 | Mami | Durres | LULJETA XHEMAL TROPLINI | 36 |
| 117 | Mami | Durres | MARSILDA MYQEREM BAXHIJA | 30 |
| 118 | Mami | Durres | MERITA RAMADAN ALLARAJ | 34 |
| 119 | Mami | Durres | MERITA SHEFQET KARAJ | 53 |
| 120 | Mami | Durres | OLTA LULEZIM KECI | 42 |
| 121 | Mami | Durres | PASHKE PJETER PALUKA | 42 |
| 122 | Mami | Durres | SAJRIE BESIM QOSHI | 44 |
| 123 | Mami | Durres | SONILA SAHIT KRRASHI | 37 |
| 124 | Mami | Durres | TEREZINA VALTER CARDAKU | 47 |
| 125 | Mami | Durres | VILMA BARDHYL TAHIRI | 27 |
| 126 | Mami | Durres | XHENI AGIM HASONI | 48 |
| 127 | Mami | Durres | XHESIKA SHPETIM RESULI | 44 |
| 128 | Mami | Durres | ZHILJANA HASAN HOXHALLARI | 44 |
| 129 | Mami | Fier | MIGENA FADIL MUKAJ | 45 |
| 130 | Mami | Gjirokaster | LUGERTA SHPETIM ISMAILATI | 52 |
| 131 | Mami | Korce | FJONA JORGO PASHOLLI | 35 |
| 132 | Mami | Kukes | KISMETE SHABAN HODA | 40 |
| 133 | Mami | Kukes | LONEDA IBRAHIM CENGU | 36 |
| 134 | Mami | Kukes | SIDORELA HALIM HERENI | 41 |
| 135 | Mami | Lezhe | ALBANA MUHO VOKRRI | 30 |
| 136 | Mami | Lezhe | ANTONELA GJERGJ KOLA | 41 |
| 137 | Mami | Lezhe | ANXHELIKA MARK GJOKHILAJ | 44 |
| 138 | Mami | Lezhe | ARTA GJON CUNGU | 42 |
| 139 | Mami | Lezhe | AURORA SANDER COKU (PRENGA) | 44 |
| 140 | Mami | Lezhe | BRUNILDA GJOK PRENGA | 46 |
| 141 | Mami | Lezhe | DENISA DODE PERLIKA | 48 |
| 142 | Mami | Lezhe | DILA ZEF FRROKAJ | 47 |
| 143 | Mami | Lezhe | DONIKA NIKOLL MARKU | 48 |
| 144 | Mami | Lezhe | DRILONA BASHKIM BRATA | 40 |
| 145 | Mami | Lezhe | EGLANTINA NDUE NDRELALAJ | 50 |
| 146 | Mami | Lezhe | ELSA TONIN LIKA | 36 |
| 147 | Mami | Lezhe | ERILDA GJETO PALOKAJ | 38 |
| 148 | Mami | Lezhe | HYGERTA YLLI UKU | 49 |
| 149 | Mami | Lezhe | KLODIANA GJOK PREMALAJ | 31 |
| 150 | Mami | Lezhe | MARIE KOL TOMA | 25 |
| 151 | Mami | Lezhe | ZOJE MARK BOKAJ | 48 |
| 152 | Mami | Shkoder | AGSELD AGIM DISDARI | 44 |
| 153 | Mami | Shkoder | AMANDA RASIM ZEKAJ | 41 |
| 154 | Mami | Shkoder | ANISA REMZI REXHA | 33 |
| 155 | Mami | Shkoder | ARBA AGRON RRJOLLI | 50 |
| 156 | Mami | Shkoder | ARIOLA XHELADIN HOXHA | 33 |
| 157 | Mami | Shkoder | ARJETA MUHARREM BAJRAKTARI | 52 |
| 158 | Mami | Shkoder | ARJOLA BARI ALIKAJ | 39 |
| 159 | Mami | Shkoder | ARJOLA GEZIM JUKAJ | 44 |
| 160 | Mami | Shkoder | ARNELA NDUE DODAJ | 41 |
| 161 | Mami | Shkoder | ARSIDA RASIM SMAKAJ | 50 |
| 162 | Mami | Shkoder | BESARA BEQIR VILARI | 30 |
| 163 | Mami | Shkoder | BRISELDA EDMOND NEZIRI | 36 |
| 164 | Mami | Shkoder | DIANA KOLE BUNGU | 43 |
| 165 | Mami | Shkoder | DOVINA PAL GJONI | 35 |
| 166 | Mami | Shkoder | EDONA ISA KRAJA | 38 |
| 167 | Mami | Shkoder | ELKIDA GAJRET CEKAJ | 34 |
| 168 | Mami | Shkoder | ERGYS OSMAN PLORI | 46 |
| 169 | Mami | Shkoder | ESMERALDA GJON TRUMCI | 39 |
| 170 | Mami | Shkoder | ETLEVA ISMET VETUKA | 35 |
| 171 | Mami | Shkoder | EVELINA GJERGJ SHPATI | 35 |
| 172 | Mami | Shkoder | FATIME JUZNI LAGJA | 44 |
| 173 | Mami | Shkoder | FIDARIJE RAMIZ DANI | 46 |
| 174 | Mami | Shkoder | FLUTURE SABAH KURTAJ | 44 |
| 175 | Mami | Shkoder | GERTIANA MYZAFER CENAJ | 29 |
| 176 | Mami | Shkoder | IDEN ARBEN PUCI | 39 |
| 177 | Mami | Shkoder | IRIS ALI HALLUNI | 38 |
| 178 | Mami | Shkoder | IZBJANA SELIM SELIMI | 33 |
| 179 | Mami | Shkoder | KLEA BESIM SELIMAJ | 42 |
| 180 | Mami | Shkoder | KRISTINE NDOC LIADHI | 42 |
| 181 | Mami | Shkoder | KRISTIONA NDOK QEPURI | 36 |
| 182 | Mami | Shkoder | LEARTA SAMI TRUSHI | 27 |
| 183 | Mami | Shkoder | LEONIDA FRANO FRANJO | 47 |
| 184 | Mami | Shkoder | LETA NDOKE MARKU | 44 |
| 185 | Mami | Shkoder | MANJOLA GJON GEGAJ | 50 |
| 186 | Mami | Shkoder | MANJOLA ZEF NDOJ | 33 |
| 187 | Mami | Shkoder | MARJANA PASHK PJETRI (GJONI) | 33 |
| 188 | Mami | Shkoder | MARJANA PRENG SOKOLI | 34 |
| 189 | Mami | Shkoder | MARSELA PAL TANUSHI | 33 |
| 190 | Mami | Shkoder | MEDINA RASIM KERJOTA | 37 |
| 191 | Mami | Shkoder | REZOALDA KASEM SHEGA | 53 |
| 192 | Mami | Shkoder | SAIDE SELIM METI | 44 |
| 193 | Mami | Shkoder | SIDORELA NDOC KODRA | 38 |
| 194 | Mami | Shkoder | SONILA ADEM CUKU | 48 |
| 195 | Mami | Shkoder | STELA STEFAN PANO | 40 |
| 196 | Mami | Shkoder | VALBONA PJETER GJERGJAJ | 36 |
| 197 | Mami | Shkoder | XHULJA TONIN DODAJ | 41 |
| 198 | Mami | Tirane | ADELAJDA NAZMI VARROSI | 51 |
| 199 | Mami | Tirane | AIDA HALIL SHEHI | 47 |
| 200 | Mami | Tirane | ALBINA MUSTAF ISMAHILI | 46 |
| 201 | Mami | Tirane | ANDIA ARBEN HOXHA | 53 |
| 202 | Mami | Tirane | ANGJELA HASAN HYKA | 43 |
| 203 | Mami | Tirane | ANILA FERDINANT XHAFERRI | 38 |
| 204 | Mami | Tirane | ANXHELA THANAS HYSKO | 48 |
| 205 | Mami | Tirane | ARJENTINA NEIM QEFA | 47 |
| 206 | Mami | Tirane | ARJOLA MERKUR TOCI | 48 |
| 207 | Mami | Tirane | ARTA NIKOLL DEDA | 37 |
| 208 | Mami | Tirane | BLERINA NAIFI BALLA | 46 |
| 209 | Mami | Tirane | BRINILDA PETRIT LALA | 38 |
| 210 | Mami | Tirane | BRUNILDA FATMIR ALLA | 42 |
| 211 | Mami | Tirane | DAVE GJIN GJOKA(LLESHI) | 45 |
| 212 | Mami | Tirane | DENISA ISMET HENA | 39 |
| 213 | Mami | Tirane | DRILONA KONGRES KORTOCI | 45 |
| 214 | Mami | Tirane | EDLIRA ISLAM SIDA | 34 |
| 215 | Mami | Tirane | ELONA DHIMITER PRIFTI | 51 |
| 216 | Mami | Tirane | ELONA VAIT HASA | 37 |
| 217 | Mami | Tirane | EMANUELA CLIRIM BASHALLI | 49 |
| 218 | Mami | Tirane | ENALDA YLLI DOLLOMAJA | 35 |
| 219 | Mami | Tirane | ENI NAIM RUSHEKU | 50 |
| 220 | Mami | Tirane | ENKI SHEFKI DISHANI | 41 |
| 221 | Mami | Tirane | ERISA LULZIM SHABA | 40 |
| 222 | Mami | Tirane | ERJONA AVDYL MORINA | 46 |
| 223 | Mami | Tirane | EVELINA ELMAS ZACO | 29 |
| 224 | Mami | Tirane | FABIOLA VAIT METKAJ | 33 |
| 225 | Mami | Tirane | FJORALDA NDRICIM MURATI | 33 |
| 226 | Mami | Tirane | HASIJE DALIP GROSHI | 39 |
| 227 | Mami | Tirane | IMELDA AGIM MOJSJA | 21 |
| 228 | Mami | Tirane | INA HALIL KOLGJEGJA | 47 |
| 229 | Mami | Tirane | JOHANA EDMOND HEQIMI | 46 |
| 230 | Mami | Tirane | JOLA PETRIT CELA | 47 |
| 231 | Mami | Tirane | JONIDA BASHKIM CANI | 33 |
| 232 | Mami | Tirane | JURGESA XHEFDET BELBA | 44 |
| 233 | Mami | Tirane | LEONORA PREKE GJONI | 37 |
| 234 | Mami | Tirane | LEONTINA LEK MARKU | 39 |
| 235 | Mami | Tirane | LINDITA BESNIK XHIHENAJ | 41 |
| 236 | Mami | Tirane | LORENA SHEFKI KADIU | 35 |
| 237 | Mami | Tirane | LULJETA LLAMBI PARANGONI | 31 |
| 238 | Mami | Tirane | MANJOLA NAIM KUQI | 41 |
| 239 | Mami | Tirane | MANUSHAQE FEMI HALILI | 31 |
| 240 | Mami | Tirane | MARINELA VEZIR KORCARI | 41 |
| 241 | Mami | Tirane | MEGI BASHKIM MANA | 45 |
| 242 | Mami | Tirane | MERITA REMZI SINA | 42 |
| 243 | Mami | Tirane | MEXHJANA ARTUR CONIKU | 22 |
| 244 | Mami | Tirane | MIGENA SHEFKI KADIU | 36 |
| 245 | Mami | Tirane | NAZJOLA SKENDER BEKA | 48 |
| 246 | Mami | Tirane | RIGERTA HASAN HOXHA | 48 |
| 247 | Mami | Tirane | ROMILDA JETNOR TOROLLARI | 40 |
| 248 | Mami | Tirane | RUKIJE IDRIZ BULKU | 51 |
| 249 | Mami | Tirane | SHPRESA MUSTAFA BELBA | 43 |
| 250 | Mami | Tirane | SILDA IBRAHIM KOLA | 41 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 251 | Mami | Tirane | SIOSINA SHAHIN DADJA | 43 |
| 252 | Mami | Tirane | SONILA POLIKRON XHOXHI | 40 |
| 253 | Mami | Tirane | SUELA PETRIT GJUZI | 44 |
| 254 | Mami | Tirane | VALBONA MEHMET STANI | 47 |
| 255 | Mami | Tirane | VALBONA NAIM KASAMAJ(LITA) | 49 |
| 256 | Mami | Tirane | VANESA XHEVIT ABAZI | 37 |
| 257 | Mami | Tirane | VITORIE HEKURAN BLLOSHMI | 36 |
| 258 | Mami | Tirane | VOLTEZA TELAT MIDHA | 40 |
| 259 | Mami | Tirane | XHULIA CLIRIM MUKA | 52 |
| 260 | Mami | Tirane | ZOJANA BENJAMIN HAFIZI | 28 |
| 261 | Teknik Imazherie | Durres | ARJOLD TILI CAKO | 43 |
| 262 | Teknik Imazherie | Durres | BESIM SULEJMAN BERBERI | 23 |
| 263 | Teknik Imazherie | Durres | BESMIR QERIM HARNEDARI | 30 |
| 264 | Teknik Imazherie | Durres | DIZE FETAH NOVAKU | 38 |
| 265 | Teknik Imazherie | Durres | ERVIN BESIM SHAHINI | 54 |
| 266 | Teknik Imazherie | Durres | KLOTILDA TOMOR CERA | 35 |
| 267 | Teknik Imazherie | Kukes | FATBARDHA BESNIK HAJDARMATAJ | 27 |
| 268 | Teknik Imazherie | Kukes | REDIANA XHEMALI ONUZI | 39 |
| 269 | Teknik Imazherie | Lezhe | EROLA DEDE KOCA | 44 |
| 270 | Teknik Imazherie | Lezhe | KASTRIOT IBRAHIM TAFA | 29 |
| 271 | Teknik Imazherie | Lezhe | MIKAEL GEZIM GRADECI | 32 |
| 272 | Teknik Imazherie | Lezhe | SILVA VALENTIN MALASHI | 43 |
| 273 | Teknik Imazherie | Shkoder | AMANDA BESNIK COKU | 30 |
| 274 | Teknik Imazherie | Shkoder | NAJRISA SIRJAR ZENELI | 41 |
| 275 | Teknik Imazherie | Shkoder | TEA MARK PUSI | 42 |
| 276 | Teknik Imazherie | Tirane | ADELA REFAT PLAKU | 40 |
| 277 | Teknik Imazherie | Tirane | ANXHELA AGIM BUSHI | 40 |
| 278 | Teknik Imazherie | Tirane | ARDIT BASHKIM DERSTILA | 35 |
| 279 | Teknik Imazherie | Tirane | ARIOLA MUHAMET DUSHKU | 41 |
| 280 | Teknik Imazherie | Tirane | BENUADA HAIR MERKO | 36 |
| 281 | Teknik Imazherie | Tirane | BESMIRA JORGJI BERDUCI | 31 |
| 282 | Teknik Imazherie | Tirane | BUJAR KADRI KULLA | 35 |
| 283 | Teknik Imazherie | Tirane | DERVISH RAMAZAN VRAPI | 39 |
| 284 | Teknik Imazherie | Tirane | ELDA IBRAHIM DERVISHI | 36 |
| 285 | Teknik Imazherie | Tirane | ELONA LONI GODE | 29 |
| 286 | Teknik Imazherie | Tirane | ENTELA VIKTOR GJONI | 27 |
| 287 | Teknik Imazherie | Tirane | ENXHI GEZIM DACI | 42 |
| 288 | Teknik Imazherie | | ERJONA FATRI CENKOLLARI | 39 |
| 289 | Teknik Imazherie | Tirane | ERSILDA MATI PRENDI | 28 |
| 290 | Teknik Imazherie | Tirane | FIORALBA EDMOND KOXHAJ | 25 |
| 291 | Teknik Imazherie | Tirane | FLUTURIM MUHARREM NELA | 40 |
| 292 | Teknik Imazherie | Tirane | HYJRIE MOHAMET PARESHI | 37 |
| 293 | Teknik Imazherie | Tirane | HYSNI QERIM HOXHA | 25 |
| 294 | Teknik Imazherie | Tirane | INA ENVER TABAKU | 35 |
| 295 | Teknik Imazherie | Tirane | KATOLA KASTFLUTURIMRIOT ISMAILI | 29 |
| 296 | Teknik Imazherie | Tirane | KEJVIN AGIM SHUKA | 42 |
| 297 | Teknik Imazherie | Tirane | KLAJDI AGIM JAURRI | 36 |
| 298 | Teknik Imazherie | Tirane | KLAUDIA GAZMEND XHIKOLLARI | 44 |
| 299 | Teknik Imazherie | Tirane | KLAUDIA KUJTIM NDOJ | 29 |
| 300 | Teknik Imazherie | Tirane | LIRIJE XHABIRR LILA | 39 |
| 301 | Teknik Imazherie | Tirane | MALVINA AFRIM STRAZIMIRI | 16 |
| 302 | Teknik Imazherie | Tirane | MARINELA KEL PALUCO | 36 |
| 303 | Teknik Imazherie | Tirane | MARSEZ QAZIM PUSTINA | 36 |
| 304 | Teknik Imazherie | Tirane | MEDINA AGTON SULEJMANI | 45 |
| 305 | Teknik Imazherie | Tirane | MEREME EDMOND CACA | 44 |
| 306 | Teknik Imazherie | Tirane | MIKELA ANDON HASKA | 33 |
| 307 | Teknik Imazherie | Tirane | MIRHAT XHEMALI TOCILLA | 35 |
| 308 | Teknik Imazherie | Tirane | MONIKA FADIL KOJKU | 44 |
| 309 | Teknik Imazherie | Tirane | RAJMONDA BAJRAM LUGA | 37 |
| 310 | Teknik Imazherie | Tirane | ROMINA GRAMOZ KANANI | 30 |
| 311 | Teknik Imazherie | Tirane | SILVJA SOKRAT CANALIAJ | 41 |
| 312 | Teknik Imazherie | Tirane | SKERDI ARIF HOXHA | 42 |
| 313 | Teknik Imazherie | Tirane | XHENISA XHEVDET BALLA | 41 |
| 314 | Teknik Imazherie | Tirane | XHULIA ANDON PLAKU | 34 |
| 315 | Teknik Imazherie | Tirane | XHULJA ROBERT TODO | 44 |
| 316 | Teknik Laboratori | Durres | ANA STAVRO ANGJELI | 48 |
| 317 | Teknik Laboratori | Durres | ANXHELA PELLUMB GUZI | 39 |
| 318 | Teknik Laboratori | Durres | ILIRJANA LILI PEPA | 28 |
| 319 | Teknik Laboratori | Durres | JETMIRA BAHRI BERISHA | 33 |
| 320 | Teknik Laboratori | Durres | LIRIDONA REFAT ASLLANAJ | 41 |
| 321 | Teknik Laboratori | Durres | MARSELA MUHARREM KANACI | 48 |
| 322 | Teknik Laboratori | Durres | ORNELA NOVRUZ KECI | 48 |
| 323 | Teknik Laboratori | Lezhe | AMARELTI FRAN PRENGA | 28 |
| 324 | Teknik Laboratori | Shkoder | ALKETA ERBAN DAJBABI | 50 |
| 325 | Teknik Laboratori | Shkoder | DRILONA DOD PREKA | 46 |
| 326 | Teknik Laboratori | Shkoder | ELMA SHPETIM MANI | 41 |
| 327 | Teknik Laboratori | Shkoder | EMI BESNIK LISHI | 48 |
| 328 | Teknik Laboratori | Shkoder | GERTA ZEF CARKU | 47 |
| 329 | Teknik Laboratori | Shkoder | ORKIDA AHMET SHALLARI | 47 |
| 330 | Teknik Laboratori | Tirane | ADELINA ALEKSANDRI DACI | 22 |
| 331 | Teknik Laboratori | Tirane | ADLIND THANAS COMA | 47 |
| 332 | Teknik Laboratori | Tirane | AIDA ADRIATIK GJINI | 48 |
| 333 | Teknik Laboratori | Tirane | ALDA AZEM SHEHI | 37 |
| 334 | Teknik Laboratori | Tirane | ANDELA AGRON VESKA | 41 |
| 335 | Teknik Laboratori | Tirane | ANILA JOSIF BERBOTI | 45 |
| 336 | Teknik Laboratori | Tirane | ANISA PANAJOT ZACALLI | 48 |
| 337 | Teknik Laboratori | Tirane | ANJEZA HEKURAN LUSHLLARI | 47 |
| 338 | Teknik Laboratori | Tirane | ANTRITA LIRIM PIKU | 47 |
| 339 | Teknik Laboratori | Tirane | ANXHEJANA MYRTEZAN ALINANI | 45 |
| 340 | Teknik Laboratori | Tirane | AURORA JAHO CANA | 49 |
| 341 | Teknik Laboratori | Tirane | BESJANA NDUE GJELOSHI(LEKA) | 33 |
| 342 | Teknik Laboratori | Tirane | BESMIRA RAMAZAN DOCI | 14 |
| 343 | Teknik Laboratori | Tirane | BLERTA XHEVAHIR BUDANI | 48 |
| 344 | Teknik Laboratori | Tirane | BORA XHEMAL NAZARKO | 33 |
| 345 | Teknik Laboratori | Tirane | BORANA ZAHO KALEMAJ | 43 |
| 346 | Teknik Laboratori | Tirane | DANIELA SALI DOCE | 48 |
| 347 | Teknik Laboratori | Tirane | DONIKA VELI DUKA | 48 |
| 348 | Teknik Laboratori | Tirane | DORINA PANDELI KRISTJA (LILO) | 36 |
| 349 | Teknik Laboratori | Tirane | DORJAN SHYQRI CALLIKU | 45 |
| 350 | Teknik Laboratori | Tirane | ELDA MUSTAFA KAPLLANI | 50 |
| 351 | Teknik Laboratori | Tirane | ELJONA GAZMEND RECI | 34 |
| 352 | Teknik Laboratori | Tirane | ENILA OMER DIKA | 39 |
| 353 | Teknik Laboratori | Tirane | ENKELEDA AHMET BRACJA | 46 |
| 354 | Teknik Laboratori | Tirane | ENKELEDA AGIM HOXHA (XAKA) | 40 |
| 355 | Teknik Laboratori | Tirane | ERIOLA LUAN KABASHI | 38 |
| 356 | Teknik Laboratori | Tirane | ERMAL PERPARIM MANCI | 27 |
| 357 | Teknik Laboratori | Tirane | EVA YLBER SHAMETAJ | 20 |
| 358 | Teknik Laboratori | Tirane | FIORALBA AGIM ZELA | 50 |
| 359 | Teknik Laboratori | Tirane | FJORALBA BEQIR BANE | 34 |
| 360 | Teknik Laboratori | Tirane | FLORIAN PERPARIM IBRAHIMI | 45 |
| 361 | Teknik Laboratori | Tirane | GERALDINA NAZAR GALO | 46 |
| 362 | Teknik Laboratori | Tirane | GISELDA AGIM KUBAZI | 47 |
| 363 | Teknik Laboratori | Tirane | ILDA AGRON CELA | 45 |
| 364 | Teknik Laboratori | Tirane | IVANA PETRO KRISTO | 34 |
| 365 | Teknik Laboratori | Tirane | JONIDA BESIM MALAJ | 37 |
| 366 | Teknik Laboratori | Tirane | JONIJADA MAKSIM XHAFERRAJ | 29 |
| 367 | Teknik Laboratori | Tirane | KALILA SPIRO XHORI | 34 |
| 368 | Teknik Laboratori | Tirane | KLEMENA SEFEDIN RRODHE | 43 |
| 369 | Teknik Laboratori | Tirane | KLODJANA AGIM IBRA | 41 |
| 370 | Teknik Laboratori | Tirane | KRISTJANA XHEZMI PASHAJ | 51 |
| 371 | Teknik Laboratori | Tirane | LEDINA CEL VATOCI | 42 |
| 372 | Teknik Laboratori | Tirane | MARIA ILIA MERKURI | 46 |
| 373 | Teknik Laboratori | Tirane | MARIGLENDA MEHDI SHTREZI | 40 |
| 374 | Teknik Laboratori | Tirane | MATILDA SKENDER QEMALLI | 34 |
| 375 | Teknik Laboratori | Tirane | MEGI ASQERI XIBRAKU | 50 |
| 376 | Teknik Laboratori | Tirane | MIRANDA BESNIK RAMKU | 28 |
| 377 | Teknik Laboratori | Tirane | MIRELA HAZIR HAJDARMATAJ | 35 |
| 378 | Teknik Laboratori | Tirane | MIRELA KUJTIM SHGUNI | 33 |
| 379 | Teknik Laboratori | Tirane | MIRJETA ISLAM JASHARI | 43 |
| 380 | Teknik Laboratori | Tirane | NERA ARBEN KAPO | 46 |
| 381 | Teknik Laboratori | Tirane | NEVILA GRAMOZ MALAJ | 49 |
| 382 | Teknik Laboratori | Tirane | NINA ENVER ABAZI | 38 |
| 383 | Teknik Laboratori | Tirane | OLIAN FETAH BETI | 44 |
| 384 | Teknik Laboratori | Tirane | ORJADA VASIL TODHE | 45 |
| 385 | Teknik Laboratori | Tirane | PRANVERA BAJRAM ARRA | 44 |
| 386 | Teknik Laboratori | Tirane | RAUL YMERLI MUCOLLARI | 49 |
| 387 | Teknik Laboratori | Tirane | REXHINA BUJAR HAXHIU | 41 |
| 388 | Teknik Laboratori | Tirane | SERXHO BESIM KOCI | 26 |
| 389 | Teknik Laboratori | Tirane | SIDORELA SHKELQIM MAJA | 44 |
| 390 | Teknik Laboratori | Tirane | SUELA PASHO KARRIQI | 46 |
| 391 | Teknik Laboratori | Tirane | VJODI ZYHDI DEKOVI | 49 |
| 392 | Teknik Laboratori | Tirane | XHENSILA XHAFERR QEMALA | 48 |
| 393 | Teknik Laboratori | Tirane | XHOVANA ROBERT KACOLI | 48 |
| 394 | Teknik Laboratori | Tirane | XHULJANA IFTIMI CAKALLI | 47 |

GAZETA SHQIPTARE
Life pages
Suplement
E hënë 18 Shkurt 2019 REDAKTOR: VOLTIZA DURO

## MJEKU POPULLOR



Ylli Merja: Si të shpëtoni përgjithmonë nga vesi i duhanpirjes

## INSTRUKTORI ERDI LARTI



6 rregullat që duhen ndjekur për një trup të tonifikuar

# Gerald Kola:

- Mjeku: Parandalimi, ndryshoni dietën tuaj ushqimore dhe sa më pak yndyra



# Kujdes nga gurët në tëmth, mund të mos shfaqin simptoma

"Kirurgjia kryhet për parandalimin e komplikacioneve serioze"

• Problemet me zemrën, shtoni kërpudhat në dietën ushqimore. Ja pse duhet të konsumoni një gotë verë në ditë

**Mjeku:** Parandalimi, ndryshoni dietën tuaj ushqimore dhe sa më pak yndyra

# Gerald Kola:

# Kujdes nga gurët në tëmth, mund të mos shfaqin simptoma

*"Kirurgjia kryhet për parandalimin e komplikacioneve serioze"*



Mjeku Gerard Kola

Voltiza Duro

*Në përgjithësi gurët në tëmth janë karakteristikë për femrat mbipeshë, por mund të prekin edhe personat që vuajnë nga ceroza hepatike, ata që marrin mjekim për një kohë të gjatë, individët që kanë kolesterolin e lartë. Të gjithë kategoritë e personave të sipërpërmendur kanë lidhje me kolesterolin e vetë gurët në tëmth janë lipide e kristalizime të tyre, e këto të fundit mund të ndodhë që të bashkohen e të marrin formën e një guri. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në 'Gazeta Shqiptare', mjeku Gerald Kola, tregon faktorët kryesorë të krijimit të gurëve në tëmth, simptomat, mënyrat e diagnostikimit si dhe metodat e eliminimit të tyre.*

**Si ndodh procesi i formimit të gurëve në tëmth?**

Gurët në tëmth ose kolelitiaza është prania e një ose më shumë gurëve, pra janë depozita të ngurtësuara të lëngjeve të tretjes që mund të formohen në fshikëzën e tëmthit. Ata variojnë në madhësi nga të vegjël sa një kokërr rërë dhe deri në të mëdhenj sa një top golfi. Disa njerëz zhvillojnë vetëm një gur në tëmth, ndërsa disa të tjerë zhvillojnë shumë gurë në të njëjtën kohë.

**Po llumi biliar si krijohet?**

Llumi biliar është shpesh pararendës i gurëve të tëmthit. Ai përbëhet nga bilirubinati i kalciumit, mikrokristale të kolesterolit dhe mucina. Llumrat zhvillohen gjatë ngushtimit të fshikëzës së tëmthit, siç ndodh gjatë shtatzënisë ose përdorimit të nutricionit parenteral total. Llumrat në përgjithësi janë asimptomatik (nuk japin shenja) dhe zhduken kur gjendja primare zgjidhet.

**Cilat janë simptomat që shfaqen te pacientët e prekur?**

Rreth 80% e njerëzve me gurë në tëmth janë asimptomatikë. Pjesa e mbetur ka simptoma që variojnë nga një tip karakteristik i dhimbjes, siç janë kolikat biliare dhe deri te kolecistiti apo kolangiti që janë kërcënuese për jetën. Dhimbja e barkut është simptoma më e zakonshme e cila mund të shkojë deri në shpinë ose edhe poshtë krahut. Episodet e dhimbjeve fillojnë papritmas, bëhen intensive brenda 15 minuta deri në 1 orë, mbesin në një intensitet të qëndrueshëm deri në 12 orë dhe pastaj gradualisht zhduken brenda 30 deri në 90 minuta duke lënë një dhimbje të shurdhër. Dhimbja është zakonisht mjaft e rëndë dhe i detyron pacientët të shkojnë në urgjencë për të marrë qetësues. Nauzea (përzierja) dhe të vjellat janë të zakonshme. Ethet dhe të dridhurat ndodhin vetëm nëse është zhvilluar ndonjë kolecistit. Mund të vërehet një butësi e lehtë në kuadrantin e sipërm ose një ndjeshmëri e lehtë epigastrike. Të dhënat peritoneale mungojnë. Mes episodeve, pacientët ndihen mirë.

**Mund të na tregoni disa prej llojeve të gurëve në tëmth?**

Ka disa lloje të gurëve të tëmthit. Gurët e tëmthit nga kolesteroli zënë afërsisht 85% të gurëve të tëmthit në botën perëndimore.

Gurët e tëmthit të kolesterolit formohen kur lëngu biliar është i tejmbushur me kolesterol. Tejmbushja e lëngut biliar me kolesterol ndodh nga sekretimi i tepërt i kolesterolit, por mund të rezultojë edhe nga një rënie në sekretimin e kripës biliare. Shumica e gurëve të tëmthit formohen brenda fshikëzës së tëmthit, por gurët me pigment ngjyrë kafe formohen në kanalet e fshikëzës së tëmthit.

**Si bëhet diagnostikimi?**

Ekografia e barkut! Në pacientët me kolika biliare gjithmonë dyshohet se mund të kenë gurë në tëmth. Ekografia e barkut është metoda më e përzgjedhur dhe më e mirë për zbulimin e gurëve të tëmthit, rezultatet janë të sakta deri në 95%. Ekoja, gjithashtu, zbulon me saktësi edhe llumrat. Ekografia endoskopike zbulon me saktësi gurët e tëmthit më të vegjël se 3 mm dhe mund të jetë e nevojshme vetëm nëse testet e tjera janë të dyshimta.



**Cilat janë mënyrat e trajtimit të të sëmurëve?**

Kirurgjia! Për gurët simptomatikë: Kolecistektomia laparoskopike (heqja e tëmthit me sondë) ose ndonjëherë shpërbërja e gurit duke përdorur acid ursodeoxycholic. Për gurët asimptomatike: Mbajtja nën vëzhgim e situatës me kontrolle periodikë. Shumica e pacientëve asimptomatike vendosin se sikleti, shpenzimet dhe rreziku i kirurgjisë nuk ja vlen që të heqin një organ që kurrë nuk mund të shkaktojë sëmundje klinike. Megjithatë, nëse shfaqen simptomat, heqja e fshikëzës së tëmthit kryhet për shkak se dhimbja mund të përsëritet dhe mund të zhvillohen komplikacione serioze. Kirurgjia mund të bëhet me një teknikë të hapur ose laparoskopike. Mosha e thyer zakonisht rrit rreziqet e çdo lloj operacioni.

**A ka ndonjë mënyrë tjetër kurimi përveç kirurgjisë?**

Për pacientët që nuk e pranojnë kirurgjinë ose që janë në rrezik të lartë kirurgjikal (si për shkak të çrregullimeve mjekësore shoqëruese ose moshës së avancuar), gurët e fshikëzës së tëmthit ndonjëherë mund të treten duke marrë acide biliare nga goja për disa muaj rresht. Pacientët me gurët e tëmthit asimptomatike bëhen simptomatike në një shkallë prej rreth 2% në vit. Simptoma që zhvillohet më shpesh është kolika biliare, por nuk shfaqet ndonjë komplikacion i madh biliar.

**Sapo të fillojnë simptomat e para biliare ato mund të përsëriten.**

Kolikat biliare përsëriten në rreth 20 deri në 40% të pacientëve në vit dhe afërsisht 1 deri në 2% e pacientëve në vit zhvillojnë komplikacione të tilla si kolecistiti, koledokolitiaza, kolangiti, dhe pankreatiti i gurëve të tëmthit.

**Si mund të parandalohet formimi i gurëve në tëmth?**

Acidi ursodeoxycholic nga goja mund të ndihmojë në parandalimin e formimit të gurëve në pacientët obezë të sëmurë, të cilët humbasin peshë me shpejtësi pas operacionit bariatrik ose gjatë një diete me kalori të ulta. Rekomandimi i ndryshimeve dietike lidhur me konsumin e ulët të yndyrës është deri diku efektiv pasi mund të zvogëlojë incidencën e sulmeve të kolikave biliare. Për këtë veprim nuk ka prova se mund të shkaktojë shpërbërjen e gurëve.



Mjeku popullor: Efektet negative të duhanit, mund të shkoni drejt vdekjes

# YLLI MERJA: Si të shpëtoni përgjithmonë nga vesi i duhanpirjes

## "Bimët medicinale që ju ndihmojnë në trajtim"

Voltiza Duro

Pirja e duhanit na bën keq, këtë e dimë të gjithë! Gjithashtu, nga pirja e tij mund të vdesim! Çdo vit në të gjithë botën numri i të vdekurve për shkak të duhanit po rritet me ritme të frikshme. Por efektet e cigareve në trupin e njeriut janë të shumta dhe ato ndikojnë çdo ditë në jetën e duhanpirësit. Duhani gjatë djegies çliron 4 mijë lëndë, që nga nikotina dhe monoksidi i karbonit dhe deri te katranet, substancat me përbërje benzopireni, kobalti radioaktiv, që janë ndër shkaktarët e kancerit të mushkërive. Në qoftë se do të bëjmë një listë të dëmeve që shkaktohen drejtpërdrejt nga duhani, ato që ndikohen apo rëndohen prej tij, ajo do të jetë tepër e gjatë, por le të përqendrohemi mbi dëmet kryesore. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, 90-95% e tumoreve të mushkërive shkaktohen nga pirja e duhanit. Duke folur po për mushkëritë, pirja e duhanit shkakton bronkit akut afatgjatë, bronkit kronik dhe emfizemë, si dhe incidencën dhe ashpërsinë e episodeve astmatike dhe infeksionet e përsëritura të frymëmarrjes. Pirja e duhanit është shkaktari kryesor i infarktit dhe i sëmundjeve koronare të zemrës te gratë dhe burrat dhe veçanërisht ajo është e lidhur me 30% të vdekjeve nga sëmundjet koronare të zemrës. Duhani rrit rrezikun e arteriosklerozës dhe të infarktit miokardik, sepse ai favorizon formimin e pllakave dhe formimin e trombeve. Sëmundja koronare arteriale shkaktohet nga monoksidi i karbonit dhe nikotina. Ajo është një nga sëmundjet më të zakonshme në vendet e zhvilluara. Duhanpirësit rrezikojnë të sëmuren dy herë më shumë sesa ata të cilët nuk e pinë atë. Tymi i duhanit është një faktor rreziku shumë i rëndësishëm në mosfunksionimin e organeve gjenitale të meshkujve. Një studim i kryer në Masashuta ka treguar se si pirja e duhanit rrit rrezikun e impotencës, me një incidencë mes 5% dhe 15% më të lartë sesa ajo e joduhanpirësve. Por duhani nuk ka një efekt të dëmshëm vetëm mbi nivelin e enëve të gjakut, por ai ka një rol të drejtpërdrejtë edhe në indet gjenitale të mashkullit. Edhe nga pikëpamja estetike duhanpirja ka një ndikim negativ mbi trup. Në fakt, duhani zvogëlon mbrojtjen imunitare përkundrejt pllakave bakteriale, shkakton një zverdhje të dentinës dhe rrit rrezikun e gingivitit. Përveç këtyre, duhani përshpejton plakjen e lëkurës. Të pish duhan gjatë shtatzënisë do të thotë të bësh një krim, sepse kjo gjë mund



Mjeku popullor Ylli Merja

t'i shkaktojë dëme të përhershme fëmijës tuaj ose në raste të tjera mund t'ju shkaktojë dështim spontan. Një grua shtatzënë, e cila pi duhan ka një rrezik më të madh për të lindur fëmijë të vdekur ose të lindë një fëmijë nën peshë. Gjithashtu, pirja e duhanit gjatë shtatzënisë mund të shkaktojë një vonesë në rritjen dhe zhvillimin mendor të fëmijës, si dhe të mushkërive. Pirja e duhanit rrit rrezikun e kancerit të fshikëzës, mëlçisë, laringut, ezofagut, pankreasit dhe gojës. Duhani, përveç këtyre, është një faktor rreziku për zhvillimin e diabetit në kohë të hershme. Kur kombinohet me pirjen e alkoolit ky rrezik shkon 150/1 në raport me popullsinë joduhanpirëse. Duhani, duke kontribuar në vazokonstruksionin (ngushtimin) e enëve të gjakut të stomakut rrit përqindjen për ulcerën e stomakut, ndërkohë që rritet 2,7 herë rrezikun për kancer në stomak. Duhani shkakton shumë sëmundje dhe është i dëmshëm për shëndetin e njeriut. Njerëzit mundohen ta lënë duhanin, por nuk munden, pasi ata janë mësuar ta konsumojnë shumë atë. Disa njerëz mendojnë se duhani të largon dhimbjen e kokës, por përkundrazi ai e shton akoma më shumë atë, por ne nuk e ndiejmë.



### Trajtimi me bimë medicinale

Bima e tërfilit ngjyrë mishi rritet në lartësinë në 800-1500 metra mbi nivelin e detit. Në momentin që ky tërfil përzihet me duhanin, arrin të neverisë cigaren e çon deri në lënien përfundimtare të këtij vesi. Kjo bimë ka një magji çudibërëse, e pasi e përziejmë me duhanin, mund të konsumohet njësoj siç pihet një cigare, në raportin 1:1. Ndërsa për personat, mushkëritë e të cilëve janë rënduar së tepërmi nga duhanpirja, këshillojmë që të shtojnë edhe pak sherebelë në përzierje apo zhumbricë. Të tria këto bimë së bashku, arrijnë të krijojnë idenë që je i ngopur me duhan. Tërfili ngjyrë mishi në këtë rast, shërben si një balancues, e frenues i hormonit të mosngopjes, në mënyrë që ky i fundit mos të japë efektin e vet në gjak. I gjithë ky proces vjen duke rralluar cigaret që pi individi, jo si një ndërprerje e menjëhershme, nga dy paketa rrallohet në 30, 20, 15 cigare e kështu me radhë. Shumë shpejt ndihen edhe efektet fiziologjike, pasi mushkëria fillon të bëjë një vetpastrim, prandaj ne i hedhim përzierjes pak zhubricë apo sherebelë. Më tej fillon nxjerrja jashtë e sekrecioneve e njëkohësisht përdoruesit nëse do të përziejnë duhanin me këtë tërfil nuk duhet të behen merak pasi urina do të fillojë të ndryshojë ngjyrën.

# Instruktori ERDI LARTI: 6 rregullat që duhen ndjekur për një trup të tonifikuar

Voltiza Duro

Trupi është veshja më e bukur që kemi" dhe kjo shprehje vlen më shumë për stinën e nxehtë të verës. Kështu, nëse doni që këtë verë të keni një trup dhe fizik më tërheqës, ky është momenti të filloni nga puna. Në këtë shkrim për suplementin "Life Pages" në 'Gazeta Shqiptare', Erdi Larti, instruktor palestre tregon disa nga rregullat kryesore sesi mund të fillojmë të bëhemi gati për një "beach body".

### Filloni aktivitetin fizik

Ky është hapi i parë pa të cilin nuk mund të formosh një trup të tonifikuar. Dhe nëse doni që këtë verë të tërhiqni vëmendje me fizikun tuaj, duhet ta merrni shumë seriozisht këtë hap. Filloni të paktën 2 deri në 3 herë në javë duke u ushtruar nga 1 orë si fillim. Nëse jeni sistematikë në stërvitje më besoni do të keni rezultate shumë shpejt.

### Zgjidhni aktivitetin fizik që ju pëlqen më shumë

Kjo është dilema, çfarë do të bëj dhe ku do të shkoj?! Ka pafund vende ku mund të stërviteni. Ka fitness, cross fit, zumba, kërcime latine, etj. Pyeteni veten se ku do të ndjeheshit më komode dhe nuk do të mërziteshit. Duhet të filloni të merreni me diçka që ju pëlqen sepse nëse zgjidhni një lloj aktiviteti që nuk është në preferencat tuaja do të përfundoni duke e braktisur shumë shpejt. Mund të jeni natyrë sfiduese kështu mund të zgjidhni fitnesin, i cili për hir të vërtetës do shumë vullnet dhe është vendi im I preferuar. Mund të zgjidhni cross fit nëse doni intensitet dhe ju pëlqen të stërviteni në grup, nëse përveç stërvitjes doni edhe të argëtoheni mund të shkoni në zumba ose në kërcime latine. Ju e njihni më mirë veten tuaj prandaj kjo zgjedhje ju takon vetëm ju.

### Ushtroni muskujt e barkut

Barku, pjesa më delikate e trupit… Nëse do të filloni të kujdeseni që tani padiskutim në verë nuk do të keni një probleme me fryrjen. Ushtrimet e barkut janë nga ato ushtrime që mund ti bësh kudo dhe kurdo. Filloni nga 20 - 30 minuta çdo ditë.



Instruktori Erdi Larti

### Kujdesuni për ushqimet që duhet të konsumoni

Që gjërat të funksionojnë, duhet ti zbatoni të gjitha rregullat. Jo vetëm stërvitje dhe me ushqimin ta tepronit ose anasjelltas, jo vetëm dietë ushqimore dhe pa aktivitet fizik. Ato janë të ndërlidhura me njëra - tjetrën. Kur fillon të bësh aktivitet fizik duhet ta ndihmosh atë me ushqimin e duhur. Duhet të përfshini në dietën tuaj ushqimore ushqime me proteina si vezë, peshk, qumësht, fileto pule, perime, etj. Proteina ndihmon në rigjenerimin dhe formimin e muskujve. Kështu do mund të formoni më shpejt një trup të tonofikuar. Ushqimet që duhet të mbani larg janë ato me yndyrë, brumërat, të skuqurat, sheqeri dhe ushqimet e procesuara.



### Konsumoni 5 vakte në ditë

Dikush ndoshta do të mendojë instiktivisht që me 5 vakte nuk dobësohet dot, ose janë shumë. E keni gabim. Të konsumosh diçka çdo 2 orë, kjo do të ishte idealja për organizmin tonë, gjithsesi 5 vakte është menduar duke marrë parasysh edhe rrethanat që njerëzit janë në punë, shkollë dhe nuk mund të jenë kaq strikt. Duhen ngrënë 3 vakte kryesore dhe 2 mesvakte. Mëngjesi , paradreka, dreka, paradarka dhe darka. Këto minivakte para drekës dhe darkës duhet të jenë vakte të vogla ku mund të konsumoni fruta të thata, fruta, çaj ose pak bukë. Duhet të keni kujdes sasinë. Kur hamë vakte të vogla dhe të shpeshta, trupi jonë nuk ndjehet i uritur, dhe metabolizmi punon më shpejt. Jemi më energjikë dhe eficient gjatë ditës.

### Mos harroni të pini ujë

Pini 2 deri në 3 litra ujë në ditë. Pini ujë edhe kur ndjeni uri, sepse kështu do të ndjeheni të ngopura dhe do të konsumoni më pak ushqim. Uji hidraton trupin dhe ju largon mbetjet toksiske. Të flasësh për vetitë e ujit nuk mjaftojnë këto rreshta, por mbani mend rregullin kryesor, që uji është pija më e shëndetshme që mund të konsumoni. Këto ishin disa nga rregullat që do ju ndihmojnë nëse i ndiqni të gjitha njëkohësisht. Trupi juaj do fillojë të reagojë pas zbatimit të këtyre 6 rregullave.





# Këshilla



# Problemet me zemrën, shtoni kërpudhat në dietën ushqimore

Kërpudha është një ushqim, i cili po "humb" me kalimin e kohës. Në Egjiptin e lashtë, faraonët e konsideronin si ushqimin më të shijshëm, i cili u sillte shumë të mira për organizmin, ndërsa atë e përdornin edhe në mjekësinë popullore. Ndër 4.000 lloje kërpudhash që ekzistojnë, vetëm 100 prej tyre janë të ngrënshme. Këto të fundit mund të zgjidhen të freskëta, të thata ose të grira. Të freskëtat apo të thatat kanë karakteristikat më të mira ushqyese. Mundësia për t'i tharë apo për t'i ngrirë ato e bëjnë këtë ushqim të disponueshëm gjatë gjithë vitit. Nëse kërpudhat i blini të freskëta, atëherë duhet të bëni kujdes që të mos jenë me myk, ndërsa koka dhe bishti i tyre duhet të jenë të fortë. Shumë mendojnë që kërpudhat janë një ushqim i rrezikshëm për linjat tona, por në të vërtetë nuk është kështu. Ato kanë një përmbajtje kalorike vërtet të ulët, 11 kcal/100 g për kërpudhat e freskëta dhe 296 kcal/100 g për ato të thatat. Gjithsesi, kjo varet edhe nga shumëllojshmëria e kërpudhave që hamë. Pra, e sigurt është që ato nuk kanë yndyrë. Kështu që kërpudhat janë të përsosura për t'u përfshirë edhe në dieta të ndryshme dobësimi. Pjesa më e madhe e kërkimeve mjekësore ka konfirmuar të mirat që kërpudhat i sjellin organizmit tonë. Studimet më të fundit janë përqendruar veçanërisht në katër lloje të kërpudhave mjekësore, maitake, shiitake, reishi dhe krimet. Maitake e shiitake kultivohen në veri të Indisë dhe janë shumë të shtrenjta, por edhe të vështira për t'u gjetur. Ndërsa disa lloje kërpudhash që mund të gjenden lehtë, të tilla si bisporus agaricus janë të njohura për aftësinë e tyre për të luftuar fillimin e lloje të ndryshme të kancerit, kolesterolin e ulët, për të luftuar sëmundjet inflamatore dhe për të parandaluar sëmundjet kronike, në sajë të pranisë së antioksidantit të fuqishëm ergotioneinës. Kërpudhat janë të dobishme në luftimin e sëmundjeve kardiovaskulare dhe në frenimin e formimit të kolesterolit në arterie. Ato përmbajnë vitaminë B3, e cila ndihmon në funksionimin e duhur të sistemit nervor dhe vitaminë B2, e nevojshme për prodhimin e qelizave të kuqe të gjakut për metabolizmin e yndyrave, proteinave dhe karbohidrateve.





# Ja pse duhet të konsumoni një gotë verë në ditë

**Në ditët e sotme dihet pothuajse nga të gjithë se vera është e rëndësishme për organizmin tonë, sepse ajo përmban vitamina, oligoelemente, hekur, si dhe përbërës të tjerë që gjenden në të në një nivel më të ulët. Të dhënat epidemiologjike që janë bërë në kuadër të promocionit të dietës mesdhetare e lidhin konsumimin e verës me një incidencë të ulët të infarktit të miokardit, që paraqesin edhe sot hipoteza të vlefshme për mënyrën e të jetuarit dhe të punuarit sesa këshilla të karakterit farmaceologjik. Por edhe teprimi në shifra për rreziqet e tmerrshme të përdorimit të alkoolit si sëmundjet e pankreasit po të tjera patologji të aparatit të tretjes, ku më e tmerrshmja konsiderohet Cirroza hepatike, nuk duhet të kufizojnë konsumimin e verës. Një sintezë objektive për rolin e verës në të ushqyer ose për kufijtë e një sigurie absolute dhe madje deri në një avantazh të mundshëm të dobisë së saj është e vështirë të bëhet, dhe kjo lidhet me përbërësin kryesor të pijeve alkoolike, etanolin dhe efektet e tij. Etanoli furnizon me kalori, por edhe me lëndë toksike potenciale, duke përbërë një rrezik patologjik që mund të çojë në varësinë nga alkooli dhe degradimin e personave që e përdorin në sasi të mëdha. Ndjenja e nxehtësisë që pason tretjen e verës ose në masë të madhe të super-alkoolikëve shpreh jo aq vlerat energjetike të alkoolit sesa veprimin e tij farmakologjik si vazodilatator periferik. Alkooli ka karakteristikat e një karburanti me rendiment të ulët, sepse mund të aktivizojë rrugët metabolike me pak prurje energjie, ose mund të prishë rregullimin termik me djersitje të ekzagjeruara. Prandaj duke njohur potencialin toksik të kuotës së alkoolit, te verërat mund të vihen në dukje edhe anët pozitive të verës, por gjithmonë duke pasur parasysh dozat, gradacionin dhe mënyrat e konsumimit të saj, me kufizimet dhe ndalimet e duhura, për grup-mosha të caktuara, për gjini dhe gjendje fiziologjike. Duhet theksuar se ndalimi i verës është kategorik në patologjitë që lidhen me mëlçinë.**

# SHQIPTARËT NË GREQI
## INTERVISTA

### Kreu i shoqatës "Arogi": Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet pensioneve

# Shqiptari Fatos Malaj, hedh kandidaturën për deputet në parlamentin grek

## "Programi, ja lehtësirat për emigrantët në Greqi"

Voltiza Duro

Për shumë vite, ai ka qenë një mbështetje për emigrantët shqiptarë në Greqi, e madje ka hartuar edhe projektligjin për nënshtetësinë e brezit të dytë si dhe atë të lejeve të qëndrimit për nënat me fëmijë të lindur në Greqi. I pozicionuar si ndërmjetës ndërkulturor në Ministrinë e Emigracionit, njëkohësisht edhe si kreu i shoqatës Arogi (Përkrahja) në shtetin helen, Fatos Malaj i ka ardhur në ndihmë bashkëatdhetarëve të tij nëpërmjet promovimimit të të drejtave të emigrantëve. Në një intervistë për Gazeta Shqiptare, Malaj bën me dije se për tu gjendur edhe më pranë shqiptarëve, ka hedhur kandidaturën për deputet në parlamentin grek, si një shembull i mirëintegrimit edhe një shtet të huaj. Ai zbardh arsyet e pozicionimit krah partisë Pasok, si dhe disa nga pikat e programit elektoral që do tu sjellin më shumë lehtësira për shqiptarët në Greqi.



Kandidati për deputet në parlamentin grek, Fatos Malaj

**PROGRAMI ELEKTORAL MBI ÇËSHTJET E EMIGRACIONIT:**

➤Reforma e përgjithshme të politikës ekzistente për emigracionin, me qëllim integrimin e plotë dhe marrjen e shtetësisë;
➤Masa për bashkimin familjar pasi ka akoma persona të cilët, me gjithë qëndrimin e tyre shumëvjeçar në Greqi, nuk mund të bashkohen ende me familjet e tyre;
➤Dy çështje të tjera shumë të rëndësishme janë ato të sigurimeve shoqërore dhe pensioneve.
➤Tema e parë lidhet me atë që në Greqi quhet pensioni bazë kombëtar (ethniki sintaksi), çështje kjo që mund të konsiderohet edhe diskriminuese pasi u jep një shumë më të ulët emigrantëve në krahasim më të gjithë qytetarët e tjerë.
➤Vëmendje të veçantë i kam kushtuar gjithashtu mundësisë për tranferimin e të drejtës së pensionit në vendin e origjinës.
Programi parashikon edhe:
➤Uljen e kostos së taksave mbi lejen e qëndrimit (paravolo);
➤Zbatimin e ligjit për sa i përket mësimdhënies në gjuhën amtare.

**POZICIONIMI TEK PASOKU**

> Arsyet janë komplekse. PASOK-u si forcë politike ishte i pari që i afroi emigrantët në radhët e tij. Qysh në fund të viteve '90, ishte e para parti politike e cila në statusin e saj parashikonte pjesëmarrjen e emigrantëve në organet partiake, pavarësisht mungesës së shtetësisë. Me ardhjen në pushtet në 2009, qeveria e Jorgos Papandreu kaloi në parlament ligjin për shtetësinë e brezit të dytë, i ashtuquajturi 'ligji Ragusi'. I njëjti ligj krijoi këshillat e integrimit të emigrantëve në çdo bashki si dhe u dha të drejtë vote në zgjedhjet lokale pa qenë e nevojshme të kenë shtetësinë greke.

**Si lindi ideja e kandidaturës për deputet në parlamentin grek?**

Për shumë vjet jam angazhuar me problemet që emigrantët kanë hasur në Greqi, nga ato më të thjeshtat deri tek ato më të ndërlikuarat, përfshirë edhe problemet sociale në përgjithësi. Këtu mund t'i referohem kontributit tim personal në hartimin e projektligjit për shtetësinë e brezit të dytë të emigrantëve si dhe për lejen e qëndrimit për nënat me fëmijë të lindur në Greqi. Nga ky ligj kanë përfituar afërsisht 70.000 emigrantë. Falë rolit tim në promovimin e të drejtave të emigrantëve si dhe vizionit të demokracisë pjesëmarrëse të artikuluar nga forca politike "Lëvizja për Ndryshim" (PASOK) kandidimi erdhi si një zhvillim mëse i natyrshëm.

**Pse pikërisht ndërmorët këtë hap në këtë periudhë?**

Pas një rrugëtimi të trazuar migrator 28 vjeçar, tashmë kushtet janë të plotësuara. Emigrantët janë të integruar duke u bërë një pjesë shumë e rëndësishme e shoqërisë greke si nga aspekti demografik ashtu edhe nga ai socio-politik. Shoqëria greke, nga ana tjetër, është ndërgjegjësuar për dinamikën që mbartin dhe rolin që luajnë emigrantët në zhvillimin ekonomik si dhe prosperitetin e shoqërisë greke. Duke marrë parasysh këto parametra del në pah domosdoshmëria e artikulimit politik dhe e përfaqësimit në organin më të lartë të demokracisë siç është parlamenti grek.

**A ka pasur më parë një kandidim nga ana juaj për t'u bërë deputet?**

Kjo është hera e parë që unë kam vënë kandidaturën për deputet.

**Pse u pozicionuat në radhët e partisë PASOK, cilat janë arsyet?**

Arsyet janë komplekse. PASOK-u si forcë politike ishte i pari që i afroi emigrantët në radhët e tij. Qysh në fund të viteve '90, ishte e para parti politike e cila në statusin e saj parashikonte pjesëmarrjen e emigrantëve në organet partiake, pavarësisht mungesës së shtetësisë. Me ardhjen në pushtet në 2009, qeveria e Jorgos Papandreu kaloi në parlament ligjin për shtetësinë e brezit të dytë, i ashtuquajturi 'ligji Ragusi'. I njëjti ligj krijoi këshillat e integrimit të emigrantëve në çdo bashki si dhe u dha të drejtë vote në zgjedhjet lokale pa qenë e nevojshme të kenë shtetësinë greke. Një arsye tjetër që vendosa të përfaqësoj këtë forcë politike është angazhimi dhe aderimi im që në fillimet e mia në Greqi në strukturat e saj. Si u referova edhe pak më lart, Lëvizja për Ndryshim (PASOK) ka dhënë maksimumin për emigrantët dhe integrimin e tyre edhe në kohët më të vështira politike dhe socio-ekonomike në Greqi.

**Cilat janë disa nga pikat në programin tuaj elektoral që do të sjellin lehtësira për emigrantët shqiptarë që jetojnë në shtetin helen?**

Kemi një program të plotë për sa i përket çështjeve të emigracionit. Mund të theksoj këtu: Reformën e përgjithshme të politikës ekzistente për emigracionin, me qëllim integrimin e plotë dhe marrjen e shtetësisë; Masa për bashkimin familjar pasi ka akoma persona të cilët, me gjithë qëndrimin e tyre shumëvjeçar në Greqi, nuk mund të bashkohen ende me familjet e tyre. Dy çështje të tjera shumë të rëndësishme që kanë vëmendjen time të plotë janë ato të sigurimeve shoqërore dhe pensioneve. Konkretisht, tema e parë lidhet me atë që në Greqi quhet pensioni baze kombëtar (ethniki sintaksi), çështje kjo që mund të konsiderohet edhe diskriminuese pasi u jep një shumë më të ulët emigrantëve në krahasim më të gjithë qytetarët e tjerë. Vëmendje të veçantë i kam kushtuar, gjithashtu, mundësisë për transferimin e të drejtës së pensionit në vendin e origjinës. Programi parashikon edhe: Uljen e kostos së taksave mbi lejen e qëndrimit (paravolo); Zbatimin e ligjit për sa i përket mësimdhënies në gjuhën amtare. Këto janë padyshim vetëm disa prej pikave. Programin e plotë e kemi postuar edhe në faqet e mia zyrtare në rrjetet sociale nga ku mund të informohet cilido në detaje.

**Çfarë mendoni të sillni ndryshe nëse arrini të bëheni deputet në parlamentin grek?**

Përveç simbolikës që mbart zgjedhja për herë të parë e një emigranti në Tempullin e Demokracisë, ndryshimi konsiston në plotësimin e pikave të lartpërmendura që janë pjesë e programit tim politik.

**Sa e vështirë është kjo garë për ju?**

Padyshim që është një sfidë e vështirë jo vetëm personale, por edhe kolektive. Çdo gjë e re që shfaqet në shoqërinë dhe politikën e një vendi përbën në vetvete një sipërmarrje të vështirë. Por sikurse kumbon edhe slogani ynë "Bashkë ndryshojmë - Bashkë jetojmë" jemi të sigurtë për suksesin.

### Java e 14 e protestave, "jelekverdhët" sulmojnë filozofin

## Trazira në Paris, publikohet video ku protestuesit fyejnë rëndë hebreun Finkielkraut

Jelekëverdhët nuk e ndalën dhunën për të 14-tën javë radhazi. Ligji i javës së kaluar që synonte të ndalonte tubimet e tyre nuk bëri asnjë efekt. Dhuna ishte e të njëjtit intensitet. Bujë këtë javë shkaktoi një video e publikuar në rrjetet sociale, ku një grup protestuesish shfaqen duke drejtuar fyerje të rënda anti-semite ndaj filozofit francez me origjinë hebreje Alain Finkielkraut. Në video dëgjohen fjalët "Zionist i ndyrë", "Racë e poshtër" e "Populli do të të ndëshkojë". Në një intervistë për të përditshmen "Journal du dimanche", Finkielkraut tha se kishte ndjerë urrejtje të ashpër nga protestuesit. Rasti u dënua përmes 'Twitter' nga presidenti Emmanuel Macron, i cili tha se kjo ishte një nga arsyet pse nuk duheshin toleruar më tej "jelekëverdhët". Sipas tij, me fyerjet anti-semite ata bënë mohimin absolut të faktit që Franca është një komb i madh. Edhe këtë javë dhuna u shtri thuajse në të gjitha qytetet e mëdha përfshirë Parisin, Lionin e Nantën.

**SULMI NDAJ FILOZOFIT**

Bujë këtë javë shkaktoi një video e publikuar në rrjetet sociale, ku një grup protestuesish shfaqen duke drejtuar fyerje të rënda anti-semite ndaj filozofit francez me origjinë hebreje Alain Finkielkraut. Në video dëgjohen fjalët "Zionist i ndyrë", "Racë e poshtër" e "Populli do të të ndëshkojë".

### SHKURT

#### Venezuelë, opozita kërkon ndihma për vendin

Përfaqësues të presidentit kalimtar të Venezuelës, Juan Guaidó, janë në Uashington, duke organizuar ndihma nga shume vende. Ata kanë siguruar fonde të konsiderueshme, por ende nuk kanë gjetur një mënyrë se si t'i fusin ndihmat në Venezuelë. Korrespondentja e Zërit të Amerikës, Cristina Caicedo Smit njofton se shumë tonë ushqime dhe ilaçe janë bllokuar në kufirin e Kolumbisë. Në një takim të Organizatës së Shteteve Amerikane në Uashington, 25 vende premtuan mbi 100 milionë dollarë për Venezuelën. Mbi 50 vende e kanë njohur kreun e opozitës Guaidó si president. Ai po u bën thirrje vendeve të dërgojnë më shumë ndihma në vendin e tij që është zhytur në trazira. Guaido thotë se ndihmat do të hyjnë në vend më 23 shkurt. Megjithatë, Presidenti Nicolás Maduro thotë se kjo nuk do të ndodhë dhe ai fajëson sanksionet ekonomike amerikane për problemet e Venezuelës.

#### Realizohet rikonstruksioni i zemrës me indet e gjedhëve

Rikonstruksion i plotë i një barkusheje me inde të marra nga një gjedh, pas një tumori të mushkërive të një burri 62-vjeçar. Një kirurgji komplekse, e kryer me sukses më 16 janar në spitalin "Sant'Andrea" në Romë, dhe i paraqitur në një konferencë shtypi nga drejtori i Kirurgjisë në spitalin universitar "Erino Angelo Rendina". "Barkushja e majtë e zemrës së pacientit u pre dhe më pas u rindërtua me ato të gjedhit, me heqjen e plotë të tumorit të mushkërive dhe rimëkëmbjen e funksionit kardiak, një rekord italian mbase edhe botëror", theksuan studiuesit. Pacienti vuante nga një tumor i djathtë i mushkërive, i cili gjithashtu kishte sulmuar dhe pushtuar një pjesë të zemrës, një kusht që dukej se e bënte të pamundur heqjen e plotë të tumorit. "Unë u vura përballë një zgjedhjeje dhe zgjodha ta vë jetën time në duart e një personi dhe të një ekipi që me të vërtetë më ka dhënë aq shumë që nga takimi i parë. U ndjeva në duar të sigurta, ishte profesionalizmi, por mbi të gjitha stafi, që e falënderoj pa masë", theksoi pacienti Augusto Stefanaci.

### Të gjithë fajësojnë Tereza Mejin, ja fajtori i vërtetë i ngërçit

# Si Brukseli 'hodhi në erë' Brexit-in

## *Kufiri me Irlandën, çfarë rrezikon pakti i BE-së*

Nga Bruno Maçaes




Brexit, i parë nga Evropa, duket si për shumë njerëz një rrëmujë veçanërisht britanike. Por, sikur rrëmujaxhinjtë të jemi ne? Është një ide jo shumë popullore në këtë anë të Kanalit. Por ngërçi ku ka hyrë Brexit, nuk është një faji i kryeministres britanik Tereza Mej. Përkundrazi, është vetë procesi i negocimit, ai që krijoi kushtet për këtë dështim - dhe faji për këtë, është para së gjithash i Brukselit. Bisedimet e Brexit ishin të keq-përgatitura që nga fillimi - diçka që ndodh shpesh, kur ua ngarkon këtë detyrë burokratëve. BE-ja refuzoi të diskutonte natyrën e marrëdhënieve të saj të ardhshme me Britaninë e Madhe, nëse Londra nuk binte dakord që të mos kishte ndonjë kufizim të rëndë në kufirin midis Irlandës dhe Irlandës së Veriut. Ishte pikërisht vendimi për të përfshirë çështjen e kufirit irlandez në fazën e parë të negociatave, ai që siguroi mosbërritjen asnjëherë tek faza e dytë. Kanë kaluar 30 muaj, që kur Britania e Madhe evokoi nenin 50. Dhe ne vetëm sa kemi cekur pjesën e negociatave, që kanë të bëjnë me termat e marrëdhënieve të ardhshme - pjesë e diskutimeve, që në fund do të vendosë statusin e kufirit që ndan BE-në dhe Mbretërinë e Bashkuar. Tek e fundit, faza e parë sillej rreth 3 çështjeve mbi të cilat duhej vendosur në parim, dhe jo bazuar tek pragmatizmi. A do të na duhet një kufi i ashpër, një kufi i lehtë, apo gati asnjë kufi? Kjo varet nga marrëdhënia e ardhshme. Nëse ky proces ishte logjik, statusi i një segmenti të vogël të kufirit të BE-së me Mbretërinë e Bashkuar, sado i veçantë dhe jetik që mund të jetë, do të diskutohet gjatë bisedimeve mbi marrëdhënien gjithëpërfshirëse - ku do të përfshihen edhe çështje të mëdha si tregtia dhe siguria e jashtme. Për nga mënyra se si është hartuar procesi - përfshirja e kufirit irlandez në mesin e 3 temave kryesore, mbi të cilat do të negociohet përpara se Britania të largohet zyrtarisht nga blloku më 29 mars - duket se që të dyja palët duhet të arrijnë një marrëveshje, mbi një çështje që efektivisht nuk u lejohej ta diskutonin. Ekzistojnë kaq shumë pikëpyetje - për shembull, cila do të jetë marrëdhënia tregtare e Mbretërisë së Bashkuar me BE-në pas Brexit? - që varen mbi çështjen e kufirit irlandez. Nuk është çudi që ajo është ende e pazgjidhur. Atëherë, pse u përfshi në fazën e parë të diskutimeve? Brukseli mendoi që për të vepruar me përgjegjësi në procesin e negocimit, britanikët duhej t'ia fillonin nga një rezolutë e fortë për të nderuar angazhimet e tyre. Para se diskutimi të kthehej tek peshkimi, djathi dhe shërbimet bankare, Brukseli vendosi se duhej të sundonte parimi moral. Britania, vijonte arsyetimi, duhej së pari, të binte dakord të paguante paratë që duhej të kontribuonte në arkën e BE-së, të siguronte të drejtat e qytetarëve të BE-së që jetonin në Britani, dhe të respektonte pritshmëritë legjitime të të gjithë nënshkruesve të Marrëveshjes së të Premtes së Mirë, që i dha fund "Trazirave" në Irlandë. Kishte gjithashtu një arsye praktike pse Evropa donte që së pari të përqendrohej në çështjet parimore: Kjo rriste gjasat, që vendet anëtare të BE-së të qëndronin të bashkuara. Dhe kjo ka funksionuar. Përqendrimi i debatit rreth garancisë që Britania e Madhe të vepronte me mirëbesim, ndihmoi në forcimin e asaj që doli të ishte një front i bashkuar midis BE27. Megjithatë, duke pasur parasysh gjendjen e negociatave, ky mund të jetë një vendim për të cilin BE-ja mund të pendohet. Por Brukseli nuk mund ta kishte bërë këtë, pa ndihmën e kryeministres britanike. Dështimi për të rezistuar mjaftueshëm diskutimit në lidhje me çështjen e kufirit irlandez, ishte gabimi tragjik i Tereza Mej - një çështje për të cilën do të ketë kohë të mjaftueshme për t'u ulur në vitet në vijim. Heqja e pyetjes irlandeze nga faza e parë e bisedimeve, do të kishte qenë edhe në interesin e vetë BE-së. Në vend të kësaj, ajo i udhëzoi negociatorët e saj që të përçanin frontin e bashkuar të BE-së, duke u përpjekur të fusnin elementë nga faza e dytë e negociatave. Ky ishte një gabim i madh. Interesi i saj - dhe ka shumë të ngjarë edhe interesi i vendit - ishte ngadalësimi dhe jo përshpejtimi i gjërave. Mej do të përfundonte aktin e parë. Të hidhte hapat njëri pas tjetrit, duke e përfunduar Marrëveshjen e Tërheqjes në kohën e duhur - ndoshta edhe përpara afatit - dhe me prestigjin e saj të paprekur, ajo mund të kërkonte mbajtjen e zgjedhjeve të reja në vend. Duke mbajtur premtimin e saj për ta nxjerrë Britaninë nga BE-ja, askush nuk do të dyshonte qoftë edhe për një minutë, nëse ajo ishte personi i duhur për të udhëhequr Mbretërinë e Bashkuar, në një partneritet të ri me bllokun. Për këtë, kryeministrja kishte nevojë vetëm për një gjë: Të hiqte çështjen irlandeze nga fushëveprimi i Marrëveshjes së Tërheqjes. Ajo duhet të kishte investuar në atë detyrë specifike, të gjithë kapitalin e saj politik, dhe aftësitë e diplomatëve të saj të kalitur. Ky do të qe një objektiv i arritshëm. Heqja e çështjes irlandeze nga faza e parë e bisedimeve, do të kishte qenë edhe në interesat e BE-së. Pse? Sepse, pavarësisht shfaqjes së unitetit dhe këmbëngulјes se Evropa do të jetë më e fortë se kurrë, blloku gjendet vetë në një situatë delikate. Brexit ka rreziqe financiare të rëndësishme dhe Brukseli vazhdon t'i injorojë me kokëfortësi: Një përqindje e shpërpjesëtuar e shërbimeve financiare që kompanitë firmat e BE-së, duhet të menaxhojnë rrezikun e listimit në Bursën e Londrës, dhe kjo e fundit do të vazhdojë të jetë vendi ku duhet të bihen këto shërbime. Ka ndërkohë edhe rreziqe politike dhe të reputacionit. Teksa procesi i negociatave shpërbëhet, pjesa më e madhe e botës do t'i kthehet Brukselit për ta pyetur pse edhe një herë BE-ja duket e paaftë për të arritur një zgjidhje të shpejtë dhe efikase të problemeve të saj. Tek e fundit, pavarësisht BE-ja është i përbërë nga 27 ose 28 shtete, Brukseli s'mund t'u ikë problemeve që ka. Aktualisht, ekziston një rrezik shumë i madh, që klubi, në fakt, të përbëhet nga 27 anëtarë e gjysmë. Përgjithmonë. Unioni mund të rezistojë, por do të ishte dobësuar në mënyrë serioze. Fatmirësisht, ekziston një alternativë: Kthehuni te bordi i hartimit të paktit, dhe deklaroni që Marrëveshja e Tërheqjes përfundoi me sukses-pa çështjen irlandeze.

Politico.eu - Bota.al

Opinioni i Ditës

# Kosova shënon 11-vjetorin e Pavarësisë

Nga Nadie Ahmeti

(vijon nga faqja 1)

...Ata kanë përmendur partneritetin më faktorin ndërkombëtar, konkretisht më Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian.

Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 11-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, në sheshin e Prishtinës, kanë parakaluar pjesëtarët e Forcës se Sigurisë së Kosovës. Ky është parakalimi i parë që kur Kuvendi i Kosovës vitin e kaluar miratojë ligjet për transformimin e FSK-së në Ushtri.

Më këtë rast, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se Ushtria është krenaria e Kosovës.

Përveç kësaj, Thaçi ka thënë se gjatë këtij viti Kosova duhet të marrë edhe një vendim tjetër strategjik për të ardhmen e vendit, marrëveshjen paqësore, gjithëpërfshirëse që nënkupton njohje reciproke me shtetin e Serbisë.

"Jo për të harruar të kaluarën, por për të mos lejuar të përsëriten vuajtjet dhe tragjeditë e kaluara. Për këtë vendim kërkohet përsëri, urtësi, mençuri dhe unitet për të përmbyllur konsolidimin ndërkombëtar të shtetit multietnik, demokratik dhe sovran të Kosovës", ka thënë Thaçi duke shtuar se, edhe nëse arrihet marrëveshja, asnjëherë nuk do harrohet gjenocidi që ka bërë Serbia në Kosovë.

Në rrugëtimin e suksesshëm të Kosovës, presidenti i Kosovës, ka përmendur ruajtjen e partneritetit të Kosovës me Shtete e Bashkuara të Amerikës dhe me vendet e Bashkimit Evropian.

Ndërkaq, në cilësinë e mysafirëve, përveç kryeministrit të Shqipërisë Edi Rama, ishin edhe përfaqësuesit ndërkombëtarë në Kosovë, ndër ta edhe ambasadori amerikan në Prishtinë, Philip Kosnett.

Në përvjetorin e Pavarësisë, gjatë ditës është mbajtur një seancë solemne e Kuvendit të Kosovës.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj në fjalimin e tij në Kuvend, ka thënë se Kosova është e interesuar për marrëveshje reciproke me shtetin e Serbisë, por në kufijtë ekzistues.

"Shqiptarët në Ballkan janë popull që kanë kontribuar për Ballkanin dhe kontinentin tonë , janë popull po ashtu që kanë paguar çmim për të gjitha proceset nëpër të cilat ka kaluar kontinenti ynë në shekujt




e fundit. Po ashtu edhe sot janë kontribuues të paqes dhe të stabilitetit. Të gjithë ne do të punojmë në vazhdimësi për konsolidimin e shtetit tonë dhe do punojmë për marrëdhënie të mira më të gjithë fqinjët. Jemi të interesuar për një marrëveshje të quajtur obligative, ligjore, për njohje reciproke më Serbinë në kufijtë ekzistues", u shpreh Haradinaj.

Kurse kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ka thënë se 11 vjet të shtetit të ri, janë 11 vjet të rritjes më vështirësi, sfida dhe suksese të mëdha.

"Është e sigurt se këto suksese e nesërmja do t'i gjykojë si punë të jashtëzakonshme të brezit tonë, për aq sa gjykimi mbi ne do të bie edhe lëshimet e qëllimshme", ka thënë Veseli .

Veseli ka folur edhe për partneritetin me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian, taksën e vendosur nga Prishtina zyrtare për mallrat e Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës, por edhe dialogun në mes Kosovës dhe Serbisë të ndërmjetësuar nga BE-ja.

"Serbia e ka merituar dhe e meriton taksën për shkak të sjelljeve të saj karshi nesh. Por, largimi i saj është i panegociueshëm për shumë arsye. Vendimmarrja shtetërore nuk duhet të jetë përgjegjësi dhe as kritikë individuale. Në vendimmarrjen shtetërore asgjë nuk duhet të ketë personale. Pra, edhe ky vendim siç do vendim tjetër për Kosovën duhet të jetë shtetëror dhe institucional. Duhet t'i vëmë në peshore interesat strategjike të shtetit tonë përballë Serbisë, duke marrë parasysh edhe reflektimet të faktorëve determinues të botës që na rrethojnë", u shpreh Veseli.

Në përvjetorin e pavarësisë, Veseli ka shtuar se "me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian në krah Kosova është më e sigurt. Prandaj, Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës duhet të qëndrojë prapa zotimeve të përbashkëta Kosovë-SHBA dhe BE- në, në të kundërtën Kosova nuk fiton, ndërsa Serbia rehabilitohet".

Akti i shpalljes se pavarësisë se Kosovës ka ndodh më 17 shkurt 2008. Prej atëherë, Dita e Pavarësisë, për herë të parë sivjet po shënohet edhe me Ushtrinë në konsolidim e sipër, por Kosova mbetet ende vendi më i izoluar në Evropë, pa liberalizim të vizave.



Dje në "Zëri i Amerikës"

# Nju Jork: Shqiptarët mbledhin fonde për çështjen e vëllezërve Bytyçi

Nga Ilir Ikonomi

(vijon nga faqja 1)



...fondesh për familjen e tre vëllezërve Bytyqi që u vranë nga forcat Serbe në vitin 1999, në përfundim të konfliktit të Kosovës. Ilir Ikonomi ishte në Westchester të Nju Jorkut dhe na dërgoi këtë material.

Rreth 600 vetë erdhën në këtë hotel në Westchester të Nju Jorkut, për të festuar 11-vjetorin e pavarësisë së Kosovës duke grumbulluar fonde për një kauzë të veçantë: Çuarjen në vend të drejtësisë për vëllezërit Ylli, Mehmet dhe Agron Bytyçi, që u vranë nga forcat serbe në mbarim të luftës në Kosovë. Këtë vit mbushen njëzet vjet nga ajo kohë dhe në Serbi nuk janë ngritur akuza ndaj askujt për vrasjen. Por Ilir Bytyçi, vëllai i Yllit, Mehmetit dhe Agronit, është optimist:

"Duke patur Shtetet e Bashkuara të Amerikës që i bën presion Serbisë, jemi të sigurt se do ta arrijmë drejtësinë".

Për ndriçimin e çështjes, familja Bytyçi ka bërë rreth 50 udhëtime për në Serbi dhe rreth 100 në Uashington, por premtimet e Beogradit për të nxjerrë ekzekutorët para drejtësisë kanë mbetur në letër.

Komuniteti shqiptar i Amerikës po e ndihmon familjen që drejtësia të vihet në vend.

"Familja ka nevojë për fonde, sepse këto fonde do të shkojnë për avokatin, të cilit i duhen për udhëtime të ndryshme, për të shkuar në Evropë, në Uashington DC, në Departamentin e Shtetit dhe për nevoja të ndryshme",- thotë Valon Nikçi, një ndër organizatorët.

Praveen Madhiraju është avokat i familjes Bytyçi.

"Beogradi dhe prokurorët nuk kanë bërë asgjë për çështjen. Siç dihet, Presidenti Vuçiç ka bërë shumë premtime, madje edhe ka vënë gishtin te personat e dyshuar, por nuk ka bërë asgjë për këtë. Kjo e ka zemëruar komunitetin, familjen dhe Shtetet e Bashkuara dhe i ka nxitur të shtojnë trysninë për të bërë diçka tani"- thotë avokati.

Tanya Domi është profesore në Universitetin e Kolumbias:

"Në Kongresin amerikan ka shqetësim në rritje se Serbia nuk i ka përmbushur premtimet e bëra nga Presidenti Vuçiç në disa takime me amerikanët, publikisht dhe privatisht, dhe se tani është koha që ai të veprojë dhe t'i sjellë ata njerëz përpara drejtësisë."

"Jeta e tyre u vu në themelet e shtetit të Kosovës, në themelet të cilat çdo ditë e më tepër ngrihen fuqishëm mbi sakrificën e këtyre djemve e vajzave që dhanë jetën"-thotë Teuta Sahatçija, përfaqësuese diplomatike e Kosovës në Nju Jork.

Me rastin e festimit të Ditës së Pavarësisë dhe për të nderuar kujtimin e vëllezërve Bytyçi, në sallë kishte ardhur një grup policësh shqiptaro-amerikanë.

"Kam ardhur për të festuar 11-vjetorin e pavarësisë. Jam shumë i gëzuar dhe krenar. E uroj Kosovën për një të ardhme më të ndritur",-thotë Muhamet Mjeshtri, pjesë e Departamentit të Policisë të qytetit të Nju Jorkut.

Hyrja e grupit të policëve shqiptaro-amerikanë u prit me solemnitet në sallë.

Mark Gjonaj, anëtar i Këshillit të Bashkisë së Nju Jorkut, ishte ndër organizatorët kryesorë të aktivitetit:

"Sonte ne nuk festojmë vetëm pavarësinë e Kosovës, por i qëndrojmë përkrah familjes Bytyçi. Nëse nuk ka drejtësi për tre djemtë e tyre, nëse nuk ka drejtësi për tre vëllezërit tanë, nuk do të ketë kurrë paqe."

Zoti Gjonaj foli për idetë që po qarkullojnë muajt e fundit për mundësinë e korrigjimit të kufijve të Kosovës:

"Ata kufij duhet të njihen nga Serbia. Ato janë njohur nga Shtetet e Bashkuara dhe shumë vende të tjera. Ne do t'u qëndrojmë fort kufijve tanë, sepse ne nuk kemi më toka për të dhënë. Mesazhi im për Serbinë është i thjeshtë: Mitrovica, Ujmani dhe Trepça do të jenë gjithmonë pjesë e Kosovës."

Më pas, në fjalimin që mbajti përpara komunitetit, zoti Gjonaj foli me tone të ashpra lidhur me politikën e Serbisë ndaj Kosovës dhe bëri thirrje për bojkotimin e mallrave serbe.

Komentet e tij bëhen ndërkohë që zyrtarë të lartë të Shteteve të Bashkuara po e shtojnë trysninë ndaj qeverisë së Kosovës që të heqë tarifën prej 100 për qind mbi mallrat serbe të importit.

Në mbrëmje ishin edhe prindërit e vëllezërve Bytyçi, Ahmet dhe Bahrije, të cilët u përshëndetën me duartrokitje nga të pranishmit.

## HOROSKOPI

### DASHI

Bëni kujdes pasi mund të përfshiheni në një konflikt me kolegët ose shefat tuaj. Shkak për irritimin mund të jetë një mosmarrëveshje në familje. Flisni me miqtë dhe shprehni problemet tuaja, pasi do t'ju ndikojë mjaft mirë në gjendjen psikologjike.

### DEMI

Tregohuni më të kujdesshëm kur punoni me pajisje elektrike. Sa i përket anës financiare, gjërat nuk do të shkojnë ashtu siç e kishit parashikuar. Shkak për këtë mund të bëhet nisja e një aventure të re. Do të kaloni një mbrëmje romantike nën praninë e partneres/partnerit tuaj.

### BINJAKET

Do ta keni të vështirë të dalloni të vërtetën nga gënjeshtra. Kjo nuk do t'ju ndihmojë aspak gjatë një interviste për punë apo gjatë një takimi biznesi. Kërkoni të vërtetën jo vetëm përmes fjalëve, por edhe gjesteve.

### GAFORJA

Gjatë kësaj të hënë do të përballeni me disa probleme të vogla. Përpiquni që të ruani qetësinë, në mënyrë që të shkoni drejt një zgjidhjeje. Disa Gaforre do të përmirësojnë marrëdhëniet me disa miq të vjetër.

### LUANI

Luanët këshillohen të jenë më kreativë. Ka gjasa të ndihmoni një prej miqve tuaj për një çështje personale. Gjatë kësaj të hëne nuk do të keni shumë mundësi për t'u relaksuar, pasi do të jetë e mbushur plot aktivitete.

### VIRGJERESHA

Të lindurit e kësaj shenje rekomandohen të ndjekin intuitën. Ndoshta kjo do t'ju ndihmojë edhe në marrëdhëniet personale. Mos refuzoni mundësitë për udhëtime apo për ndonjë event argëtues. Ka gjasa që dikush të shfaqë dukshëm interes ndaj jush.

### PESHORJA

Duhet t'i kushtoni vëmendje të veçantë paraqitjes suaj fizike sot. Mund të merrni një ftesë për një takim romantik, i cili do t'ju bënte të ndjeheni mjaft mirë. Gjithashtu, ka gjasa që ky takim t'ju ndryshojë rrjedhën në jetën tuaj personale.

### AKREPI

Kjo e hënë do t'ju kalojë pa u vënë re. Dita e sotme do të rezultojë e suksesshme për këdo që do të dëshirojë të punojë në grup. Do t'i jepni fund një problemi me të cilin keni kohë që përballeni në familje.

### SHIGJETARI

Disa Shigjetarë do të jenë shumë optimist sot. Kjo do t'ju ndihmojë shumë nëse përfshiheni në aktivitete të ndryshme. Mund t'ju vijë një ofertë shumë e mirë që do të ketë lidhje direkte me financat tuaja. Mos refuzoni asnjë projekt.

### BRICJAPI

Bricjapët do të tregojnë rritje të interesit ndaj disa çështjeve të panjohura. Është e rëndësishme që kjo mos të ndikojë në lidhjet aktuale. Mos kërkoni të zbuloni sekrete, pasi mund të përfshiheni edhe në mosmarrëveshje.

### UJORI

Ujorët do të jenë të irrituar në disa momente të ditës. Këtë do ta shfaqni më së shumti gjatë komunikimit me familjarët. Ka gjasa që dikush pranë jush të mos mbajë një premtim që iu ka dhënë. Megjithatë, rekomandohet që të mos e gjykoni ashpër personin në fjalë.

### PESHQIT

Kjo e hënë do të jetë mjaft produktive. Nëse gjatë ditës do të përfshiheni në një konflikt, mos u tërhiqni nga qëndrimi juaj pasi mund të keni të drejtë. Bëni kujdes të mos bëheni pre e mashtrimeve.



## Qarri pranon vendimin e trajnerit

# Gjoka nuk duron më, jep dorëheqjen nga Kamza

Kamza prek sërish fundin, këtë herë humbet ndeshjen më të rëndësishme të sezonit, sfidën direkte kundër Kastriotit. Kjo duhet të ishte ndeshja ku Kamza të bënte kthesën e madhe, por në shtëpinë e tyre u tronditën në fund nga një super gol i Ymeraj. Kastrioti vijon momentin e "magjishëm" nën drejtimin e Devollit, 9 pikë në 4 ndeshjet e fundit ndezin edhe një herë shpresën e ekipit kruatan për të mbijetuar në elitën e futbollit shqiptar. Pak minuta pas humbjes me Kastriotin, trajneri i Kamzës, Ernest Gjoka, ka njoftuar edhe dorëheqjen. Tekniku, ia ka komunikuar vendimin për t'u larguar, edhe presidentit Qarri. Gjoka është tekniku i tretë i larguar nga kamzalinjtë. Më herët, pas vetëm 3 javësh, klubi shkarkoi Bledar Devollin. Pas tij, në stol erdhi Klodian Duro, e më pas edhe aventura e tij zgjati rreth 2 muaj, dhe ishte Gjoka që pranoi për të shkuar në krye të stolit. Tashmë, klubi duhet të shohë për një alternativë tjetër, teksa gjendet në vendin e fundit, i rrezikuar seriozisht për të rënë nga kategoria. Diçka të tillë, e ka konfirmuar edhe klubi në një njoftim në 'Facebook'.

Një penallti fantazmë në Kurbin bën që të kuqtë të mposhten 1-0 dhe të mbeten në +7 nga Teuta

# Laçi ndal arratinë e Partizanit Perla e Kobinas shpëton Tiranën

## Në Vlorë, Flamurtari thyen 2-0 Skënderbeun



Jeton Selimi

Duhej të ishte ndeshje ku Partizani t'i jepte një tjetër goditje rivalëve që i kërcënojnë objektivin e tyre shumëvjeçar. Duhej të ishte ndeshje ku Partizani të thellonte edhe më shumë diferencën me ndjekësit, fundja Teuta i ka bërë një dhuratë të mrekullueshme, por asnjë nga këto parashikime nuk doli, me të kuqtë që në Kurbin zhvilluan mbase ndeshjen më të keqe të sezonit. Laçi ngjallet pikërisht atëherë kur shumë pak e imagjinonin, jo vetëm që reagon po këtë e bën me një tre pikësh të plotë përballë ekipit kryesues. Në një ndeshje me pak raste për shënim dhe me shumë pak futboll aktiv, ai që vendosi sfidën ishte një vendim i gjyqtarit të takimit dhe Ndriçim Shtubina. Në minutën e 13-të Elvi Berisha reklamoi një faull brenda zonës. Kljadi Kola hezitoi për një moment, por me ndihmën e asistentit Avdo akordoi një 11-metërsh, vendim shumë i dyshimtë. Nga pika e bardhë e penalltisë Shtubina u tregua i saktë duke kaluar Laçin në avantazh, në fund rezultoi të ishte një tre pikësh. Skënder Gega u përpoq t'i jepte më shumë freski fazës ofensive në pjesën e dytë, por ishte e pa mundur të depërtonin në "fortesën" e ekipit kurbinas. Një humbje që "djeg" shumë për kryeqytetasit e ardhur pikërisht në momentin e tyre më të mirë, pikërisht atëherë kur nuk duhej. Teuta buzëqesh por dhe Kukësit, fundja diferenca mbetet tetë pikë.



**SUPERLIGA**

*JAVA E 22-të*

| | |
|---|---|
| *TË PREMTEN* | |
| Teuta - Kukësi | 2-1 |
| *TË DIELEN* | |
| Kamza - Kastrioti | 0-1 |
| Laçi - Partizani | 1-0 |
| Flamurtari - Skënderbeu | 2-0 |
| Tirana - Luftëtari | 1-1 |

*RENDITJA*

| Skuadra | N | P |
|---|---|---|
| Partizani | 22 | 46 |
| Teuta | 22 | 39 |
| Kukësi | 22 | 38 |
| Laçi | 22 | 34 |
| Skënderbeu | 22 | 33 |
| Flamurtari | 22 | 33 |
| Tirana | 22 | 25 |
| Luftëtari | 22 | 22 |
| Kastrioti | 22 | 19 |
| Kamza | 22 | 16 |

**FLAMURTARI "KAP" SKËNDERBEUN**

Flamurtari arrin një fitore të madhe në Vlorë kundër Skënderbeut, falë dy golave të shënuar në pjesën e dytë nga Andi Ribaj dhe Emiliano Musta, fitore që e lejon të mbërthejë pikërisht korçarët në vendin pestë të renditjes me skuadrat që kanë secila nga 33 pikë. Në stadiumin "Flamurtari", janë vendësit ata që tregohen më këmbëngulës që në pjesën e parë, por si në minutën e 9-të, ashtu dhe në të 23-ën, Dajsinani ka bërë mrekullinë duke u mohuar golin vendësve. Por në pjesën e dytë është i pafuqishëm gardiani i bardhekuqve, kur në minutën e 64-ët Torasa jep një asist fantastik për Ribaj, që me kokë ndëshkon Dajsinanin me daljen e tij të pastudiuar. Skënderbeu do të barazojë, por gabimi i Oto Xhon, që kërkoi ta merrte për vete golin e Krasniqit, u kushtoi korçarëve barazimin, pasi afrikani ishte në pozicion jashtë loje. Në kohën shtesë kuqezinjtë e Dajës do të shënojnë dhe golin e dytë pas një lëvizjeje fantastike në zonë të Emiljano Mustës, që në diagonale ndëshkon Dajsinanin dhe vulos rezultatin 2-0 për Flamurtarin.

**KOBINA SHPËTON TIRANËN**

Në kryeqytet Tirana dhe Luftëtari do të dhurojnë një ndeshje shumë të bukur me raste të panumërta shënimi për të dyja ekipet. Luftëtarin do të triumfojë në pjesën e parë falë golit të Albano Aleksit në minutën e 21-të. Aleksi shfrytëzoi mjaft mirë pasimin e ardhur nga e majta, duke e mposhtur Abibin në shtyllën e tij me një gjuajtje të saktë. Në pjesën e dytë si kryeqytetasit, ashtu dhe gjirokastritët shpërdoruan pa fund, teksa për t'i dhënë oksigjen tifozërisë bardheblu dhe për të tronditur miqtë, do të mendojë Kobina, që në të 94-ën lëshon një të majtë vdekjeprurëse për Ruçin, gol që do të vlejë dhe rezultatin përfundimtar 1-1, çka e lejon Tiranën ta mbajë poshtë Luftëtarin, sërish në të njëjtën distancë, pasi bardheblutë ngjiten në kuotën e 25 pikëve, ndërsa zikaltërit në 22 pikë.

## LA LIGA

# Reali turpërohet nga Xhirona, Barça arratiset në 9 pikë

Reali Madrid ka pësuar një humbje zhgënjyese, teksa është mposhtur me rezultatin 1-2 në "Santiago Bernabeu", duke i dhënë fund një serie pozitive prej 4 fitoreve radhazi. Skuadra e trajnerit Solari e nisi në mënyrën më të mirë sfidën, kaloi në avantazh në minutën e 25-të, falë golit të Kasemiros. Braziliani, në rolin e një sulmuesi, realizoi me kokë. Pjesa e parë u mbyll me avantazhin e madrilenëve. Në fraksionin e dytë, kur pritej që "Los Blankos" të thellonin shifrat, Xhirona rivendosi baraspeshën.



Miqtë fituan një penallti në të 65-tën, të shkaktuar nga Serxho Ramos. Stuani, nga pika e bardhë, mposhti portierin Kurtua. Reagimi i Realit ishte minimal, teksa 10 minuta më pas ishte sërish Xhirona, që shënoi golin e avantazhit, me anë të Portu, duke suprizuar gjithë të pranishmit. Si për të mos mjaftuar disfata, në fund kapiteni Ramos u ndëshkua me të verdhën e dytë, duke e lënë skuadrën me një lojtar më pak. Pas këtij rezultati, Reali mbetet në vendin e tretë, pas Atletiko Madrid, ndërkohë që diferenca me Barcelonën kryesuese shkon në 9 pikë, duke e vështirësuar së tepërmi rrugën drejt titullit.

## NDODH NË ITALI

# VAR-i anulon golin dhe jep penallti për skuadrën tjetër!

Që nga dita kur nisi të aplikohej sistemi VAR kanë ndodhur nga të gjitha, por episodi i fundit që vjen nga ndeshja e kampionatit italian mes Spal dhe Fiorentinës nuk ishte parë dhe as dëgjuar. Në minutën e 74-rt, kur rezultati ishte në barazim 1-1, vendasit kaluan sërish në epërsi. Por festa e tyre u shua shpejt, ndërsa gjithçka u kthye në një zhgënjim të madh. Arbitri i ndeshjes



u njoftua nga sistemi VAR, por jo për të riparë golin, i cili ishte i rregullt, por një ndërhyrje të gabuar në zonën tjetër nga edhe ku nisi aksioni. Vendimi që pasoi ishte befasues: anulohet goli i Spal dhe jepet 11-metërsh për Fiorentinën. Ky moment vendosi edhe fatin e sfidës, pasi nga pika e penalltisë, skuadra nga Firence përmbysi rezultatin dhe me pas vulosi fitoren e madhe 4-1 në transfertë.

## Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL
1. Pausini këngëtare
5. Më e mira është rekord.
9. Inicialet e Pacino-s.
11. Alessandro i pilës.
12. I ka zyrat në kufij
13. Haan ish-trainer.
14. Gjysmë mimoze.
15. Fillojnë sefte.
16. Ishte shkollë e Aristotelit.
20. Shuhen në qendër.
22. Bëhen me ambalazh.
23. Janë idhnakë.
25. Fillojnë titujt.
26. Do të bëhen pemë.
27. Ashtu si jeton heremiti.
29. Është dhomë e lartë.
30. Janë spanjolët dhe portugezët.
32. Ishte filozofi që preu damarët.
34. Janë gjuhë...veshi.
35. Është numri i dytë tek.
36. Triolet shkrimtare.
37. Kufizojnë takimet.
38. Tyler aktore.
39. Mbledh baskët separatistë.
40. Fillojnë kalimin.
41. Inicialet e Delon.
43. Lumi i Bernës.
44. Është numri të parit.
45. Një thirrje me emra.

VERTIKAL
1. Flori pa kufij.
2. Një Baba përrallor.
3. Lemper këngëtare gjermane.
4. Rastisin në krye.
5. Ai ekzekutiv u bë bashki.
6. Qendra e drogës.
7. Një tabu islamike
8. Mbyllin një dyqan.
10. Janë si zotime
11. Kryeqyteti i Lichtenstein.
12. Jaë shtyllat për vela
14. Ata të Ferrari-t qëndrojnë në box.
16. Duhen fituar me djersë.
17. Piktura pa kura.
18. Janë dokumente partie.
19. Në fund të vitit.
21. Farkëtoi armët e Akilit.
22. Një është për kërcim.
24. Athinaja e romakëve.
25. Janë kapriçit.
27. Një tis mjegulle.
28. Kërcimi i Fred Astaire.
31. Edëards regjisor.
33. Parker regjisor.
38. Luan në kufij
39. Inicialet e Rohmer.
42. Fillojnë detyrën.

## Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL
1. Matia... që këndojnë Vacanze romane.
5. Janë vendet e lira
11. Parajsa e humbur.
13. Comaneci e famshme e gjimanstikës.
15. Ekstreme në sirtar.
16. Eshtë nofka.
17. Një treshe në skenë.
19. Një provë inteligjence.
21. Gjysmë tatimi.
23. Gjysmë eolike.
24. Ekstreme në studim.
25. Bëjnë stil të lirë
28. Fillojnë kastile
29. Kalimi në kufij.
30. Një tragjedi... e Dreiser.
33. Grier aktore.
34. Dashi kur mungon ai
36. Eshtë zanore në filma
38. Kufizohet në kufij
39. Ente Civile Europiane.
40. Janë galeri në hekurudhë.
41. Ramazzotti këngëtar
42. Mbyllin një tender.
43. Agjenci Formacioni Tiranë.
44. Eshtë pjesë e borxhit që paguhet.
46. Gjysmë tandem
48. Jessica Parker aktore.
49. Inicialet e Presley.
50. Shteti i francezëve.
51. Janë brinjët në skuadër.
52. Qendër fitimi

VERTIKAL
1. George që qe as i futbollit.
2. Fillon me rruga...
3. Fundi i një faze
4. Janë në skaje
6. Eshtë vendi aderues
7. Eshtë emirat.
8. Incialet e Daudet.
9. Ndërmarrje Industriale Tiranë.
10. Igli te Lazio.
12. Janë zjarrvënës.
14. Frolich e Marlene Dietrich.
17. Kufizojnë rastet.
18. Shkroi Rinoceronti.
20. Ekstreme në slam.
22. Janë trille.
25. Qytet italian.
26. Jepen për hartim.
27. Fillojë takimet.
29. Kufizojnë kënde.
31. Janë vendet e para.
32. Një greminë.
35. Eshtë llogarin që qërohet.
36. Ndiqen me ilaçe.
37. Massari aktore italiane.
38. Janë kapot.
40. Numri i oktetit.
41. Kush ka... fërgëllon.
44. Një i fundit mbi të gjithë.
45. Një pjesë e satelitëve.
47. Në mes të një kanali.
48. Derisa janë në fund.
49. Inicialet e Taylor aktore.



## Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

## SUDOK

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 7 | | | | | 4 | | 3 | 5 |
| 6 | | | 1 | 8 | | | | 4 |
| | | 1 | | | | | | |
| | | | | | | | 4 | |
| | 7 | 9 | | 2 | | 8 | | |
| 2 | | | 8 | 5 | 9 | 3 | | |
| 4 | | | 6 | | | | 1 | |
| | 8 | 2 | 3 | | | | | |
| | | | | | | | 7 | |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

### Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8 | 3 | 6 | 2 | 1 | 5 | 9 | 7 | 4 |
| 9 | 4 | 2 | 3 | 8 | 7 | 1 | 6 | 5 |
| 7 | 5 | 1 | 4 | 9 | 6 | 8 | 2 | 3 |
| 6 | 8 | 5 | 7 | 4 | 1 | 3 | 9 | 2 |
| 1 | 2 | 7 | 5 | 3 | 9 | 4 | 8 | 6 |
| 3 | 9 | 4 | 6 | 2 | 8 | 7 | 5 | 1 |
| 2 | 6 | 3 | 8 | 7 | 4 | 5 | 1 | 9 |
| 4 | 1 | 8 | 9 | 5 | 2 | 6 | 3 | 7 |
| 5 | 7 | 9 | 1 | 6 | 3 | 2 | 4 | 8 |

## Argëtim filozofik

- Ndershmëria është kapitulli i parë në librin e mençurisë.

- Ndonjëherë gjërat e vogla marrin hapësirën më të madhe në zemrën tonë.

- Ndonjëherë preferoni heshtjen sepse ka njerëz që nuk meritojnë fjalët tuaja!

- Mos lejoni që dikush të verbojë shkëlqimin tuaj.

- Të flasësh, pëlqehesh në disa raste. Të dëgjosh, pëlqehesh gjithmonë.

- Kur një person nuk është i aftë për asgjë, atëherë ai fillon të mendojë se është i aftë për gjithçka.

Argëtim filozofik



## KRIPTOSKEME

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| S | R | | S | E | R | I | | K | O | D | A | K |
| T | A | T | A | M | I | | S | | | R | R | I |
| I | I | | H | I | P | O | T | E | Z | A | T | |
| N | | P | A | R | A | K | A | L | I | M | E | T |
| A | N | E | T | A | R | E | T | | L | A | | A |
| | | R | I | T | I | | O | | I | T | A | |
| A | T | E | | E | M | | R | A | | I | R | O |
| K | E | N | E | T | E | | I | T | A | K | A | |
| T | K | D | | | T | A | | A | N | | T | A |
| O | T | I | T | I | | G | R | | | T | | K |
| R | U | | M | I | S | I | O | N | A | R | E | T |
| E | K | S | T | R | E | M | I | S | T | E | T | |

## KRIPTOSKEME

### Përgjigja e numrit të djeshëm

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| M | E | R | L | U | C | | K | | | A | S | F |
| A | | M | A | R | A | T | O | N | I | S | T | I |
| C | A | | K | A | N | A | L | E | T | | A | J |
| E | | K | I | N | E | T | I | K | E | | F | E |
| | K | O | M | I | T | E | | | P | R | E | T |
| E | U | | I | A | T | | A | L | E | A | T | |
| N | A | H | | | I | | F | A | R | S | A | T |
| D | J | A | L | L | | P | A | S | T | A | | |
| R | T | K | | E | | T | T | T | | T | A | C |
| R | | U | D | H | A | | I | R | U | | F | I |
| A | N | | J | A | C | K | | A | R | I | E | L |
| T | I | P | A | R | E | T | | T | R | U | R | I |

## PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

### FJALËKRYQI (1)

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| G | A | R | R | O | S | | A | D | A | P | T | I | M |
| U | R | A | T | | I | P | R | I | T | I | | A | A |
| U | | K | R | O | N | I | K | A | | | E | G | T |
| S | F | I | | V | A | L | E | N | T | I | N | O | |
| | L | | M | I | N | O | T | A | U | R | I | | K |
| R | E | B | | D | I | T | A | R | I | | | T | A |
| E | T | E | R | I | | I | R | O | | A | L | A | N |
| N | O | T | I | | A | | E | S | E | N | I | N | |
| D | R | A | M | A | T | | T | S | H | I | R | T | |
| O | E | | A | R | L | | | | | J | E | A | N |
| R | T | A | | N | E | V | R | I | K | E | | L | G |
| E | | F | R | A | T | I | | M | A | T | T | I | A |

### FJALËKRYQI (2)

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P | A | N | I | K | U | | T | A | R | T | A | R | I |
| O | R | A | R | | N | F | | P | R | A | | I | R |
| | K | | A | K | I | L | I | | E | | L | T | I |
| G | A | S | | A | T | A | L | A | N | T | A | | S |
| J | | T | E | L | E | K | O | M | E | D | I | A | |
| A | M | A | N | E | T | E | | | | | K | R | E |
| H | E | R | E | M | I | T | | R | O | B | E | R | T |
| T | S | | R | I | | | M | A | R | A | T | | I |
| A | S | | G | | E | M | E | | T | S | | A | L |
| R | I | | J | A | N | I | S | | E | M | I | L | E |
| E | | R | I | | E | T | H | | K | A | N | A | N |
| T | I | R | A | N | A | | A | L | E | T | E | | I |

## Thënie të mençura

- Atje ku martesa pa dashuri, dhe dashuria pa martesë.

- Kur dikush nuk të vlerëson, nuk përpiqesh t'i ndryshosh mendim...thjesht ik....

- Momenti kur ju mendoni se duhet të dëshmoni vlerën tuaj për dikë, është momenti që duhet të largoheni menjëherë, përgjithmonë.

- Ka nga ata që pyesin pse keni humbur, ndërkohë që ishin indiferentë kur ishit atje.


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
PENSIONET E PLEQËRISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al